

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 7029  
E martë, 24 tetor 2023  
Çmimi 0.50 €

## Javë kyçe për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-së SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (V)

# KRIME ME UNIFORMA TË UÇK-së



Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë "Epokës së re", në vazhdimin e pjesës së pestë ka theksuar se botërisht dihet se një numër i konsiderueshëm i aksioneve kundër civilëve të të gjitha

përkatësive etnike në Kosovë është bërë nga kriminelë me uniforma të UÇK-së që ishin funksionarë të lartë të Shërbimit Sekret të Serbisë ose pjesëtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë. Ai ka theksuar se aksionet e tyre kriminale ishin të drejtuara kundër civilëve të të gjitha

etnike me qëllim që këto krime të shëmtuara t'i visheshin Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Bardhyl Mahmuti ka pohuar se në të gjitha rastet e vrasjeve, që sadopak janë ndriçuar, del qartë se prapa vrasjes së civilëve në Kosovë qëndron urdhri i strukturave shtetërore serbe

## AKTUALE



IZRAELI THOTË SE LUFTA NË GAZË DO TË ZGJASË DISA MUAJ

F. 2

HARADINAJ I SHOETËSUAR PËR IKJEN E MJEKËVE: GJENDJA E TYRE FINANCIARE ËSHTË E RËNDË

F. 3

KOMUNA E PRISHTINËS KËRKON RESPEKTIM TË ORARIT NGA TRANSPORTUESIT E MALLRAVE

F. 6

## EKONOMI



SHTOHEN EKSPORTET DREJT KOSOVËS, MË SHUMË PO SHITEN MATERIALE NDËRTIMI, METALE DHE USHQIME

F. 8

ROHDE: RREZIKOHEN PROJEKTE MADHORE NGA MOSMIRATIMI I MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

F. 8

## SPORT



'YLLI I JAVËS' NË SUPERLIGË, KRYEZIU: MUND TË ARRIJMË SUKSESE NË LIGËN E KONFERENCËS

F. 10

**KURTI: SULMIN TERRORIST NË BANJSKË E ORGANIZOI 'KLANI I NOVI SADIT'**

FAQE 7



**IKSHPK-ja: UJI NGA BADOCI ENDE I PAPIJSHËM, POR S'KA VEND PËR PANIK**

FAQE 3



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
+377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË



**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Partia Populiste Zvicerane ka dalë fituese e zgjedhjeve parlamentare

**BERN, 23 TETOR** - Partia Populiste Zvicerane SVP e krahut të djathtë, e cila ka bërë një fushatë agresive kundër emigracionit masiv, kryeson në zgjedhjet e përgjithshme të së dielës sipas rezultateve paraprake. Ajo siguroi 29 % të votave në zgjedhjet për dhomën e ulët të parlamentit, duke përmirësuar nivelin e

votave të saj mbi 3 %, thotë grupi i anketimeve GFS Bern. “Ne kemi marrë një mandat shumë të qartë nga zviceranët për t’i vënë në tryezë çështjet që kanë rëndësi për ta, siç është emigracioni i paligjshëm”, tha presidenti i SVP, Marco Chiesa, për transmetuesin kombëtar RTS. SVP la prapa socialdemokratët

e majtë që siguruan 18 %, dhe partinë tjetër të djathtë FDP. Liberalët ndërkohë duket se do të sigurojnë një 15 %, çka i vendos në pozicionin e më të kërkuarve për koalicion. Ndërkohë, të Gjellbrit nuk mund të përsërisnin fitoren e tyre dramatike të zgjedhjeve të fundit më 2019 dhe u zvogëluan katër pikë

përqindjeje për të përfunduar 9 %, sipas projeksioneve.

“Tani do të jetë akoma edhe më e vështirë të luftosh për koston e jetesës, barazinë dhe politikën klimatike”, tha Cedric Wermuth e Partisë Socialdemokrate.

Zvicra, një vend i pasur evropian me 8.8 milionë banorë, votoi për 200 vendet



në dhomën e ulët të parlamentit dhe te 46 vendet në dhomën e lartë të Këshillit të Landeve.

## Izraeli thotë se lufta në Gazë do të zgjasë disa muaj



**JERUSALEM, 23 TETOR** - Ministri i Mbrojtjes i Izraelit, Yoav Gallant, ka thënë se lufta e Ushtrisë Izraelite në Rripin e Gazës mund të zgjasë “dy deri në tre muaj”, duke u zotuar se “pasi të përfundojë ajo, nuk do të ketë më Hamas”. “Sa iu përket anëve operacionale të manovrimit në fund të fundit, asgjë nuk do ta ndalë IDF-në [Forcat e Mbrojtjes së Izraelit]. Është një përzjerje e dy gjërave: aftësive tona ajrore dhe manovrimeve tokësore”, tha Gallant të dielën në Tel Aviv. Një pushtim tokësor i Rripit të

Gazës nga Ushtria e Izraelit mund të jetë i pashmangshëm, pas sulmit të tërbuar të militantëve të Hamasit në qytetet jugore të Izraelit para dy javëve. Ushtria e Izraelit e rrethoi Gazën dhe i nisi bombardimet hakmarrëse vdekjeprurëse në Gaza menjëherë pas sulmit të 7 tetorit, si dhe ka grumbulluar tanke dhe dhjetëra mijëra trupa në afërsi të kufirit me enklavën me popullsi të dendur prej 2.3 milionë banorësh. “Ky duhet të jetë operacioni ynë i fundit i manovrimit në Gazë, për një

arsyeje të thjeshtë, sepse pas tij nuk do të ketë më Hamas atje”, theksoi Gallant.

Militantët e Hamasit i thyen pengesat kufitare dhe u futën nga Gaza në jug të Izraelit më 7 tetor, duke i vrarë mbi 1 400 njerëz, kryesisht civilë, dhe duke i rrëmbyer mbi 200 të tjerë.

Si pasojë e bombardimeve të pashmangshme që nga atëherë në Gaza janë vrarë 4 741 palestinezë, ndërsa 15 898 janë plagosur, sipas Ministrisë së Shëndetësisë së Gazës, e cila udhëhiqet nga Hamas.

## Liderët e Perëndimit e ritheksojnë mbështetjen për Izraelin, por i kërkojnë t’i mbrojnë civilët

Liderët e Shteteve të Bashkuara, Kanadasë, Francës, Gjermanisë, Italisë dhe Britanisë së Madhe e ritheksojnë përkrahjen e tyre për Izraelin dhe të drejtën e tij për t’u vetëmbrojtur por, po ashtu, i bënë atij thirrje t’i përmbahet ligjit ndërkombëtar humanitar dhe t’i mbrojnë civilët.

Në një komunikatë të përbashkët të dielën mbrëma për luftën e Izraelit me grupin militant, Hamas, liderët e mirëpritën lirimin e dy pengjeve nga Hamasi, si dhe bënë thirrje për lirimin e menjëhershëm të të gjitha pengjeve të tjera.

Presidenti amerikan Joe Biden e thirri takimin virtual me liderët e vendeve të Quint-it, ShBA, Francë, Gjermani, Britani e Madhe, Itali dhe Kanada, pasi kishte biseduar me kryeministrin e Izraelit, Benjamin Netanyahu.

Thirrjet e tyre u bënë për shkak të rritjes së frikës se lufta mes Izraelit dhe Hamasit mund të përhapet në një konflikt të gjerë në Lindjen e Mesme, pasi Izraeli i vazhdoi bombardimet ndaj Gazës dhe përleshjet në

kufirin libanez u shtuan.

Në deklaratë, Bideni, kryeministri kanadez Justin Trudeau, presidenti francez Emmanuel Macron, kancelari gjerman Olaf Scholz, kryeministrja italiane Giorgia Meloni dhe kryeministri britanik Rishi Sunak, u zotuan për të punuar ngushtë së bashku për t’i mbështetur qytetarët e vet në rajon, posaçërisht ata të cilët duan të largohen nga Gaza.

Ata e mirëpritën dërgimin e autokolonave të para me ndihma humanitare në Gazë dhe u zotuan se do të punojnë me partnerët rajonalë për të garantuar “qasje të sigurt dhe të qëndrueshme” në ushqim, ujë, kujdes mjekësor dhe ndihma të tjera humanitare për 2.3 milionë banorët e Gazës.

Bideni dhe Netanyahu biseduan për mbështetjen e ndihmave të para në Gazë dhe “ritheksojnë se dërgimi i këtyre ndihmave vendimtare do të vazhdojë”, sipas Shtëpisë së Bardhë.


## Nxënësit që dy muaj pa libra në Maqedoninë e Veriut

**SHKUP, 23 TETOR** - Nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme në Maqedoninë e Veriut edhe muajin tetor po e mbyllin me mungesë të teksteve mësimore, me gjithë premtimin e Ministrisë së Arsimit se problemi me librat do të zgjidhet deri në mesin e këtij muaji.

Situatë më e vështirë paraqitet në arsimin fillor, ku edhe mungesa e teksteve shkollorë është më e madhe. Nxënësit e klasave të gjashta

që kanë nisur vitin shkollor sipas një programi të ri mësimor kanë mungesë të shumë teksteve. Ndërsa, klasat e tjera kryesisht mësojnë nga libra të dëmtuar pasi janë përdorur shumë vjet nga gjeneratat e kaluara. Mungesë të librave ka edhe në shkollat e mesme dhe kjo ka bërë që mësimdhënësit ta bojkotojnë mësimin për t’i alarmuar institucionet mbi nevojën e zgjidhjes së problemit. “Gjuha angleze

është një lëndë e cila pa libra nuk mund të mësohet dhe këtë e dinë të gjithë: nxënësit, mësuesit, prindërit dhe të gjithë ata që janë të përfshirë në mbarëvajtjen e procesit mësimor. Kemi pengesë të madhe në procesin mësimor. Ky tekst ka gati dhjetë vjet që nuk është ndërruar dhe është bërë i papërdorshëm pasi është dëmtuar, shkarravitur”, thotë Lulzim Lazami, mësimdhënësi në arsimin e mesëm në Tetovë.



Ministri i Arsimit, Jeton Shaqiri, më 9 tetor tha se ka nisur botimi i librave të rinj për disa lëndë mësimore dhe

se deri nga mesi i muajit ato t’u shpërndahen nxënësve, por vetëm nxënësve të klasave të gjashta.



## Haradinaj i shqetësuar për ikjen e mjekëve: Gjendja e tyre financiare është e rëndë

PRISHTINË, 23 TETOR - Në kuadër të ciklit të diskutimeve lidhur me gjendjen e rëndë në vend, grupi parlamentar i AAK-së ka organizuar të hënën tryezë diskutimi në lidhje me situatën në shëndetësi dhe çështjen e sigurimeve shëndetësore. Lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se gjendja në sektorin e shëndetësisë është e rëndë. Ai ka theksuar se duhet të ndërmerren masa që të

funksionalizohet sistemi informativ shëndetësor dhe të punohet për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. “Gjendja vazhdon të mbetet e rëndë në shëndetësi, pra jo e mirë. Çdoherë kur takohemi, diskutimet tona duhet të fokusohen si të dilet nga kjo gjendje e rëndë në shëndetësi. Një aspekt i rëndësishëm i ecjes përpara është funksionalizmi i sistemit informativ shëndetësor, pra data-baza e

cila është e domosdoshme në çdo nivel. Në çdo qeveri është bartur çështja e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, ndërsa tash duhet ta arrijmë momentin që të veprojmë. Përdërisa nuk veprojmë, gjendja po vazhdon e tillë me rreziqe të shumta”, ka thënë Haradinaj. Ndërsa deputeti i AAK-së, Shemsedin Dereshaj, ka thënë se kjo parti është duke i kushtuar rëndësi shëndetësisë, raporton EO.



## IKShPK-ja: Uji nga Badoci ende i papijshëm, por s'ka vend për panik

PRISHTINË, 23 TETOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) njoftoi të hënën se uji nga fabrika e ujit në Liqenin e Badocit vazhdon të jetë i papërdorshëm për pije dhe përgatitje të ushqimit, por shtoi se nuk ka vend për panik.

Më 20 tetor Instituti u kishte kërkuar qytetarëve që furnizohen me ujë nga kjo fabrikë të mos e përdorin atë për pije dhe përgatitje të ushqimit për shkak të vlerës së shtuar të manganit.

Të hënën IKShPK-ja tha se është duke bërë përcjelljen në vazhdimësi të cilësisë së ujit në Liqenin e Badocit. “Analizat e fundit laboratorike tregojnë për rënie të vlerave referente të manganit në ujin e liqenit dhe në rrjetin shpërndarës, por që ende nuk janë arritur vlerat sipas standardeve të parapara në Udhëzimin Administrativ nr. 10/2021 - cilësia e ujit për konsum nga njeriu”, ka njoftuar IKShPK-ja në “Facebook”.

Instituti shtoi se uji mund të përdoret për pastrim, mirëmbajtje të higjienës dhe ambienteve të banimit si dhe për nevoja të tjera, “por jo edhe për përgatitje të ushqimit sepse vlimi i ujit nuk e zvogëlon sasinë e manganit”.

Vlerat e shtuara të manganit në ujin e Liqenit të Badocit vijnë si pasojë e faktorëve natyrorë dhe njerëzorë, tha eksperti i ujërave,



Skënder Bublaku, për “Radion Evropa e Lirë” më 21 tetor. Bublaku thotë se si “liqen relativisht i vjetër” janë disa faktorë që bëjnë që në Liqenin e Badocit të mund të shfaqet herë pas here mangani në vlera më të larta.

Sipas një raporti të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, mangani është një element esencial për shumë gjallesa,

përfshirë këtu edhe njerëzit. Por, “efekte të padëshirueshme në shëndetin e njerëzve mund të shkaktohen nga marrja e pamjaftueshme ose ekspozimi i tepërt [ndaj manganit]”.

Departamenti qeveritar i Kanadasë për Shëndetësi, Health Canada, thotë se mënyra më e lehtë e absorbimit të këtij elementi është përmes ujit të pijshëm. Por, ky departament

shton se nëse uji që ka nivele më të larta të manganit sesa që lejohet konsumohet vetëm për periudha të shkurtra kohore, “nuk ka gjasa të shkaktohet ndonjë problem shëndetësor”. E nëse pirja e ujit të kontaminuar me nivele më të larta të manganit bëhet për një periudhë më të gjatë kohore, atëherë mund të shfaqen probleme shëndetësore.

“Fëmijët dhe të rriturit që pinë ujë me nivele të larta mangani për një kohë të gjatë mund të kenë probleme me kujtesë, përqendrim dhe aftësi motorike. Foshnjat (nën një vjeç) mund të kenë probleme të të mësuarit dhe sjelljes nëse pinë ujë me shumë mangan në të”, thuhet në uebfaqen e Departamentit të Shëndetësisë në Minesota të ShBA-së.

## Kurti dhe Sveçla pritën në takime lamtumirëse ambasadorin Minxhozi

PRISHTINË, 23 TETOR - Kryeministri Albin Kurti ka pritur të hënën në takim lamtumirës ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi.

Gjatë bashkëbisedimit në këtë takim të përzemërt, Kurti e ka falënderuar ambasadorin Minxhozi për punën, angazhimin, mbështetjen dhe bashkëpunimin gjatë gjithë mandatit të tij, si dhe për kontributin e çmueshëm në ruajtjen dhe përparimin e marrëdhënieve të shkëlqyeshme.

Ambasadori e ka falënderuar kryeministrin për mikpritjen,

komunikimin e rregullt dhe bashkëpunimin e afërt. U vlerësua angazhimi i përbashkët me qëllim përmirësimin në jetën e qytetarëve dhe bizneseve, si dhe lehtësimin e problematikave të mbartura ndër vite, në fushat e sigurisë, tregtisë, drejtësisë, arsimit e kulturës.

U theksuan marrëdhëniet dypalëshe ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë, nënshkrimi i gjithsej 184 marrëveshjeve, protokolleve e memorandumeve, si dhe niveli i zbatueshmërisë së marrëveshjeve të deritanishme.



Edhe ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka pritur të hënën në takim lamtumirës ambasadorin Minxhozi, të cilin e ka falënderuar për angazhimin e tij përgjatë viteve për avancimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve në mes të dy vendeve tona.

Me këtë rast ai ka vlerësuar bashkëpunimin si dhe përkushtimin e ambasadorit Minxhozi për t'i përafuar edhe më shumë qytetarët e vendeve tona. Ministri ka theksuar se angazhimi mes dy vendeve do të thellohet edhe më tej në shërbim të qytetarëve të dy vendeve.





INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-SË  
SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (V)

# KRIME ME UNIFORMA TË UÇK-së

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë "Epokës së re", në vazhdimin e pjesës së pestë ka theksuar se botërisht dihet se një numër i konsiderueshëm i aksioneve kundër civilëve të të gjitha përkatësive etnike në Kosovë është bërë nga kriminelë me uniforma të UÇK-së që ishin funksionarë të lartë të Shërbimit Sekret të Serbisë ose pjesëtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë. Ai ka theksuar se aksionet e tyre kriminale ishin të drejtuara kundër civilëve të të gjitha përkatësive etnike me qëllim që këto krime të shëmtuara t'i visheshin Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Bardhyl Mahmuti ka pohuar se në të gjitha rastet e vrasjeve, që sadopak janë ndriçuar, del qartë se prapa vrasjes së civilëve në Kosovë qëndron urdhri i strukturave shtetërore serbe

PRISHTINË, 23 TETOR -

**"Epoka e re":** Kur bëhet fjalë për vrasjen e civilëve gjatë luftës në Kosovë, ju gjithmonë keni mohuar në mënyrë kategorike përfshirjen e UÇK-së në këto krime. Më intereson të di nëse një qëndrim i tillë përjashton mundësinë që të ketë pasur edhe shqiptarë që kanë kryer akte kriminale kundër civilëve?


**Bardhyl Mahmuti:** Qëndrimi ynë nuk ka të bëjë me përkatësinë etnike të kriminelëve, por me urdhërdhënësit. Tani botërisht dihet se një numër i konsiderueshëm i aksioneve kundër civilëve të të gjitha përkatësive etnike në Kosovë

është bërë nga kriminelë me uniforma të UÇK-së që ishin funksionarë të lartë të Shërbimit Sekret të Serbisë ose pjesëtarë të ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë.

Fillimisht po marr si shembull kolonelin e policisë serbe, Slavko Niki (Slavko Nikiq). Me qëllim që lexuesi shqiptar të krijojë idenë se për çfarë personi bëhet fjalë, po përmend disa të dhëna që i ka bërë publike ky kriminel. Në veprën e tij "Grupi i jakut O" (Nulta Krvna Grupa", f. 8), Slavko Niki pohon se "sa i përket qëndrimit ndaj jetës, nga personalitetet më të shquara të skenës politike,

policore dhe ushtarake serbe, më së shumti çmon gjeneralin Ratko Mladi (Ratko Mlladiq)". Besoj se lexuesit e dinë që Ratko Mladi është një ndër kriminelët më të mëdhenj të Ballkanit, i dënuar me burgim të përjetshëm nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për veprat penale gjenocid, krim kundër njerëzimit dhe krime lufte në Bosnjë. Qëndrimi i Ratko Mladiit për jetën u dëshmuar veçanërisht në Srebrenicë, ku më 13 korrik 1995, forcat serbe të komanduara nga ai, masakruan përafërsisht 8 000 pjesëtarë të përkatësive etnike myslimane. Më 16 gusht 2008,

në emisionin televiziv "irilica", në TV Pink, Slavko Niki pohoi me mburrje se "për kontributin



që kishte dhënë për serbët e matanë lumit Drina, gjenerali Ratko Mladi i kishte dhënë mirënjohje të veçantë dhe, me udhëzimet e tij, si kolonel lufte, ishte dërguar në luftën e Kosovës në krye të Njësitit për Detyra të Veçanta!". Ai nuk tregon në cilat aksione ka marrë pjesë gjatë luftës në Kosovë por, siç shihet nga përzgjedhja që ka bërë të vendosë në ballinën e librit "Rrëfim-Ndoshta" fotografinë e vet me uniformë të UÇK-së, mund të supozojmë se të çfarë natyre ishin krimet e Njësitit për Detyra të Veçanta. Nuk mund ta di konkretisht në cilat krime ka marrë pjesë



Foto: Kriminelë serbë të veshur me uniforma dhe emblemë të UÇK-së



koloneli i policisë serbe Slavko Niki. Këtë çështje mund ta sqarojë vetëm një proces hetimor që do të kishte për qëllim ndriçimin e rasteve të krimeve të pandriçuara deri tani. Mirëpo një gjë është e sigurt: të veshur me këtë uniformë as ai dhe as kriminelët e tjerë të Njësitit për Detyra të Veçanta nuk kanë marrë pjesë në luftime kundër ushtarëve të UÇK-së. Aksionet e tyre kriminale ishin të drejtuara kundër civilëve të të gjitha përkatësive etnike me qëllim që këto krime të shëmtuara t'i visheshin Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kosovës dhe për t'ia veshur UÇK-së krimet që kishte kryer me porosi të Shërbimit Sekret Serb. Në prill të vitit 2015, në emisionin "Zona e Debatit" në "Klan Kosova", deklarova se "Nazim Bllaca ishte person i infiltruar nga Serbia për të kryer krime me qëllim të fajësimit dhe njollosjes së UÇK-së dhe se kishte qëndruar në Serbi përpara se të rrefente, në nëntor të vitit 2009, për krimet që i kishte kryer në Kosovë". Katër vjet më vonë, më 8 shkurt 2019, emisioni hulumtues i Radio Televizionit të Kosovës, i titulluar "Udhëve", nxori dëshmi të pakontestueshme të angazhimit të Nazim Bllacës në

vegla të këtij shërbimi, që kryenin operacione të veçanta. Nuk kam asnjë dyshim se të gjitha krimet ndaj civilëve në Kosovë janë kryer me urdhër të strukturave shtetërore serbe, pa marrë parasysh përkatësinë etnike të ekzekutorëve të këtyre krimeve.

**"Epoka e re":** Në bazë të pohimeve të ish-shefit të Shërbimit Sekret të Serbisë, përmasat e krimeve ku ishte i përfshirë ky shërbim ishin jashtëzakonisht të mëdha.

**Bardhyl Mahmuti:** Ish-shefi i Shërbimit të Sigurimit Shtetëror të Serbisë, Radomir Markovi dhe

kryerjen e krimeve flasin faktet: nga data 23 shkurt 2001, kur u arrestua Radomir Markovi, e deri më 16 janar 2018, kur u vra Oliver Ivanovi, mbi 95 % e rasteve të vrasjeve të pandriçuara janë kryer në pjesën veriore të Kosovës, ku, pa u penguar fare, kanë operuar forcat kriminale të dirigjuara nga Beogradi zyrtar.

Në mesin e personave për të cilët njoftoi Shërbimi Sekret i Serbisë se ishin vrarë në pjesët e tjera të Kosovës, dy persona janë pa emër dhe pa mbiemër (numër rendor 705 dhe 706, në "Librin e bardhë", botimi 2001), dhe një Qerim Ismajli, i vrarë në Godanc të Epërm, në komunën e Shtimes.

E shoh të rëndësishme të sqaroj për lexuesin se Qerim Ismajli ishte i afërt i pushtetit të Sllobodan Millosheviqit, të cilin Radomir Markoviqi e kishte emëruar Sekretar të Përgjithshëm të partisë politike me emrin "Iniciativës Demokratike të Kosovës", që regjimi u përpoq të krijonte në Kosovë. Kryetari i kësaj "partie shqiptare", Faik Jashari, dhe kryetari i një partie tjetër "shqiptare" (Partia Demokratike Reformiste e Shqiptarëve), Sokol Qysja, gjithashtu e krijuar nga regjimi i Millosheviqit, ishin pjesëtarë të "delegacionit serbo-jugosllav", në Konferencën e Rambujesë.

ndriçuar, del qartë se prapa vrasjes së civilëve në Kosovë qëndron urdhri i strukturave shtetërore serbe, pa marrë parasysh përkatësinë etnike të ekzekutorëve dhe pa marrë parasysh nëse të gjithë pjesëmarrësit në vrasje ishin në dijeni se kush qëndronte prapa vendimeve të tilla.

**"Epoka e re":** Ish-shefi i Shërbimit Sekret të Serbisë e thotë qartë se urdhrat vinin nga Sllobodan Millosheviqi. Mirëpo pas përmbyesjes së Millosheviqit nga pushteti, shtetet e demokracive perëndimore mbështetën shpresat te qeveria e "re" e Serbisë për ta ndriçuar fatin e mijëra të zhdukurve. Është e tmerrshme kur sheh se pushtetarët e ri në Beograd jo vetëm që vazhduan logjikën e vjetër të regjimit të Sllobodan Millosheviqit, por në disa aspekte ia kaluan shumëfish.

**Bardhyl Mahmuti:** Regjimi i Sllobodan Millosheviqit zbatoi disa forma të zhdukjes së gjurmëve të krimet të gjenocidit në Kosovë qoftë nëpërmjet djegies së kufomave në furrat e minierave në Feronikel, në Trepçë, në Bor dhe në Surdulicë, qoftë nëpërmjet zhvarrosjes së kufomave të shqiptarëve të vrarë dhe varrosjes në varreza masive anekënd Serbisë. Sa iu përket listave të sajuara nga Shërbimi Sekret i Serbisë, deri në botimin e vitit 2001 flitej për qindra "të vrarë, të rrembyer ose të zhdukur nga



Foto: Kriminelë serbë të veshur me uniforma dhe emblemë të UÇK-së

Si shembull të dytë po përmend Nazim Bllacën, pjesëtar i Shërbimit Sekret Serb, i cili me detyrë nga ky shërbim futet në Kosovë dhe kryen një varg krimesh.

strukturat e Shërbimit Sekret të Serbisë, zyrtarisht që nga data 15 maj 1997. Në funksion të realizimit të qëllimeve të Shtabit Strategjik të Sllobodan Millosheviqit, në

shefi i eskadronëve të vdekjes, Milorad Ulemek-Legija, u dënua nga Gjykata e Qarkut në Beograd me nga 40 vjet burg për dhënie urdhri, porosi të vrasjeve të shumta në Serbi dhe kryerje të

vrasjeve. Dënimi prej 40 vjetësh është dënimi maksimal që parasheh Kodi Penal i Serbisë. "Në kërkesën për falje të dënimit që i adresoi kryetarit të asokohshëm të Serbisë, Tomislav Nikoli-it, Radomir Markovi kërcënoi se do ta rrezojë Serbinë në gjunjë nëse e publikon listën e krimeve të bëra me urdhër të Millosheviqit kundër serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë". Kërcënimi i tij është tepër domethënës! Për ta gjunjëzuar një shtet, përmasat e përfshirjes së shtetit në krime të

kësaj natyre duhet të jenë jashtëzakonisht të mëdha. Të mos harrojmë se një gjë të tillë e pohoi njeriu që ka qenë në krye të strukturës shtetërore që përpilonte planet e realizimit konkret të krimeve kundër civilëve në Kosovë. Se çfarë ndikimi ka pasur ky person në

vrasjet e civilëve në Kosovë kanë qenë të përfshirë edhe Selim Broshaj, Ibush Kllloqi, Lutfi Ajazi, Ajat Istogu, Jakup Hoti, Nazim Bllaca e shumë kriminelë të tjerë të përkatësive etnike shqiptare që ishin funksionarë të lartë të Shërbimit Sekret të Serbisë apo informatorë dhe



Pas përfundimit të luftës në Kosovë, Nazim Bllaca shkoi në Serbi dhe jetoi për një kohë relativisht të gjatë atje. Për saktësinë e datës kur ka shkuar, të kohës sa ka banuar atje dhe të vendit ku ka qëndruar në Serbi, e di më së miri Nazim Bllaca, familjarët e tij dhe Shërbimi Sekret Serb. Kam bindjen e plotë se shumica e lexuesve janë dëshmitarë të përpjekjeve të këtij bashkëpunëtori të okupatorëve serbë, sidomos nga muaji nëntor i vitit 2009, për t'u prezantuar para opinionit publik si pjesëtarë i Shërbimit Informativ të



Në numrin rendor 32 të "listës së të vrarëve pas 10 qershorit 1999", të botimit të vitit 2001 të "Librit të bardhë", të titulluar "Viktimat e terrorizmit shqiptar në Kosovë dhe Dukagjin- Personat e vrarë, të rrembyer dhe të zhdukur, janar 1998-nëntor 2001", Shërbimi Sekret i Serbisë sqaron se "Qerim Ismajli është vrarë më 31 gusht 2001, nga Fahredin Gashi". Pas deklaratave publike të Nazim Bllacës për përfshirjen e tij në një numër vrasjesh pas luftës në Kosovë, ky informator i Shërbimit Sekret të Serbisë përmend edhe Fahredin Gashin si pjesëtar në kryerjen e këtyre vrasjeve. Siç shihet, në të gjitha rastet e vrasjeve, që sadopak janë

UÇK-ja". Për dallim nga koha e Millosheviqit, në "librat e bardhë" që shpërndau qeveria e "re" e Serbisë në vitin 2001 dhe 2003, përveç pjesëtarëve të forcave të armatosura serbe që u zhvendosën në listën e civilëve, një pjesë e emrave të atyre që ishin varrosur në varrezat masive në Serbi, apo që dihej zyrtarisht se ishin vrarë nga forcat e armatosura serbe, u zhvendosën në listën e civilëve "të vrarë, të rrembyer ose të zhdukur nga UÇK-ja". Kështu nëpërmjet manipulimeve "demokratike" të listave të viktimitave, numri i viktimitave që i visheshin UÇK-së arriti në 3 276!

(Muhamet Mavraj / Vijon)

Zrteve albansgog terrorizma na Kosovu i Metohiji (Ubijsna, oteta i nestala lica, januar 1998 - novembar 2001)

Žrtve	Ubijsni gradani		Otet i nestali gradani		Ukupno
	01.01.1998 - 10.06.1999.	11.06.1999 - 01.11.2001.	01.01.1998 - 10.06.1999.	11.06.1999 - 01.11.2001.	
Srbi i Crnogorci - civilni	87	709	155	1002	1953
Albanci - civilni	230	67	64	/	361
Ostale nacionalnosti - civilni	18	71	25	152	266
Pripadnici VJ	351	/	30	/	381
Pripadnici MUP-a	230	/	13	/	243
Neidentifikovane žrtve	72	/	/	/	72
	988	847	287	1154	3276
	1835		1441		

• Spisak ubijenih građana na Kosovu i Metohiji  
• Spisak otetih i nestalih građana na Kosovu i Metohiji



## Fillon renovimi i Klinikës së Onkologjisë

PRISHTINË, 23 TETOR - Qendra Klinike Universitare e Kosovës ka njoftuar të hënën se në bashkëpunim dhe mbështetje të Ministrisë së Shëndetësisë ka filluar renovimi i Klinikës së Onkologjisë, në të cilën do

të ketë rritje të kapaciteteve dhe shtretërve për pacientët.

Po ashtu, QKUK-ja ka njoftuar se pacientët që kanë qenë të shtrirë në katin e dytë të Klinikës së Onkologjisë janë zhvendosur në hapësirat

afër Sterilizimit Qendror, hapësirë kjo që më parë ka shërbyer për pacientët si ambulanca specialiste të Klinikës së Ortopedisë. "Shërbimet ambulatore, ato të Radioterapisë dhe Brahiterapisë, do të vazhdojnë të ofrohen në

Klinikën e Onkologjisë. QKUK kërkon mirëkuptim nga të gjithë pacientët e Klinikës së Onkologjisë që marrin shërbime ambulatore, meqë njëkohësisht do të punohet për rinovim të katit të dytë", ka njoftuar QKUK-ja.



## Miku i Kosovës, Reto Nause, fiton votat për Parlamentin e Zvicrës me partinë e Qendrës

BERN, 23 TETOR - Të dielën janë mbajtur zgjedhjet parlamentare në Zvicër. E miku i Kosovës, Reto Nause, i cili ka qenë në garën për deputet me Partinë e Qendrës, ka arritur t'i fitojë votat për të hyrë në parlamentin zviceran.

Nause njihet si mbështetës i Kosovës. Ai e ka vizituar vendin tonë së bashku me veprimtarin Sali Bislimi, i cili jeton dhe vepron në Zvicër.

Politikani zviceran Nause gjatë vizitës në Kosovë, i shoqëruar edhe nga Sali Bislimi, është takuar me personalitete të ndryshme të politikës si dhe ka vizituar Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz.

Reto Nause më 16 tetor të vitit 2018 ishte dekoruar nga presidenti Hashim Thaçi në atë kohë me Medaljen e Dhjetëvjetorit të Pavarësisë.

Thaçi i kishte shprehur mirënjohje Nauses për kontributin për promovimin e Kosovës në Zvicër dhe për përkrahjen e dhënë për komunitetin e Kosovës atje.

Reto Nause përmes shumë veprimeve të tij ka treguar se i do shqiptarët në përgjithësi, madje në zyrën e tij është parë edhe me plis të bardhë në kokë.

Reto Nause aktualisht ka pozitën e drejtorit të Sigurisë dhe Energjetikës në Bern.



## Komuna e Prishtinës kërkon respektim të orarit nga transportuesit e mallrave



PRISHTINË, 23 TETOR - Inspektorati i kryeqytetit të hënën që nga orët e hershme të mëngjesit në pika të ndryshme në Prishtinë ka zhvilluar kontrolle inspektuese mbi zbatimin e vendimit të

kryetarit Përparim Rama, lidhur me orarin e përcaktuar të furnizimeve nga të gjithë transportuesit e mallrave - furnitorëve në kryeqytet.

Qarkullimi i të gjithë



transportuesve të mallrave në kryeqytet, sipas vendimit të kryetarit Rama, do të lejohet sipas këtij orari, në Zonën I, që përfshin pjesën qendrore të kryeqytetit, nga ora 19:00 deri të

nesërmen në orën 07:00 në mëngjes; në Zonën II, që përfshin pjesën perëndimore të kryeqytetit, nga ora 18:00 deri të nesërmen në orën 07:00 në mëngjes. Ndërkaq

bulevard/sheshi i kryeqytetit, nga ora 23:00 deri të nesërmen në orën 07:00 në mëngjes, për mjetet deri në 3.5 t.

Inspektorati i kryeqytetit ka kërkuar nga të gjitha subjektet afariste që të respektohet ky orar, përndryshe do të jenë të detyruar të ndërmarrim masa në përputhje me vendimin e kryetarit Rama dhe kornizën ligjore në fuqi.

Në njoftimin e Drejtorisë së Inspeksionit thuhet se kanë pranuar numër të madh të ankesave nga shumë qytetarë të Prishtinës mbi vështirësitë dhe problemet e shumta që transportuesit e mallrave - furnitorët - janë duke shkaktuar në zona të ndryshme në kryeqytet gjatë qarkullimit të tyre dhe gjatë parkimit dhe zbrazjes së mallrave në destinacionet përkatëse.

## Vendoset gurthemeli i çerdhes së re në Godancë të Shtimes

SHTIME, 23 TETOR - Në Godancë të Shtimes, kryeministri Albin Kurti vendosi gurthemelin e çerdhes së re. Kurti theksoi se ky projekt dëshmon përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, së Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe komunës së Shtimes, për të investuar dhe për t'u kujdesur për fëmijët

që janë edhe e tashmja, edhe e ardhmja e vendit tonë. "Kjo është çerdhja e 31-të në mesin e atyre që i kemi ndërtuar, rinovuar e adaptuar", ka thënë kryeministri.

Ai ritheksoi se Qeveria e Kosovës mbetet e angazhuar për investime në edukimin e hershëm, andaj deri më tash ka investuar 10.7 milionë euro për çerdhe, ndërsa janë

edhe 5 milionë të tjera prej fondeve IPA të Bashkimit Evropian.

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka bërë me dije se së shpejti pritet të finalizohet edhe çerdhja e cila është duke u ndërtuar në Myzeqinë, gjersa për vitin e ardhshëm është paraparë edhe çerdhja në Petrovë.





# Kurti: Sulmin terrorist në Banjaskë e organizoi 'Klani i Novi Sadit'

"A nuk do të duhej që BE-ja dhe ShBA-ja ta formojnë një Gjykatë Speciale për 'Klanin e Novi Sadit'? Mafia ballkanike do të përjetonte goditje fatale, ndërkaq rajoni i Ballkanit do të hapej i tëri për demokraci evropiane, drejtësi ligjore, paqe të qëndrueshme dhe zhvillim të përshpejtuar", ka theksuar të hënën kryeministri Albin Kurti

PRISHTINË, 23 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha të hënën se sulmin, siç u shpreh ai, "paramilitar dhe terrorist", ndaj Policisë së Kosovës në veri të vendit, e kreu "Klani i Novi Sadit" i udhëhequr nga ministri i Mbrojtjes i Serbisë, Millosh Vuçević.

Një rreshter i Policisë së Kosovës u vra më 24 shtator në fshatin Banjaskë të komunës së Zvečanit, pasi policia u sulmua nga një grup serbësh të armatosur. "Sulmin paramilitar e terrorist në Banjaskë të Zvečanit e ka organizuar 'Klani i Novi Sadit'. Në krye të tij ndodhet ministri i Mbrojtjes i Serbisë, Millosh Vuçević. Ai është kryetari i partisë-shtet SNS, tri herë i zgjedhur kryebashkiak i Novi Sadit me ndihmën e Zvonko Veselinoviçit, dhe miku më i afërt i vëllait të presidentit të Serbisë, Andrej Vuçiq. Rreth 40 pelegrinë ortodoksë në Manastir të Banjaskës më 24 shtator ishin nga Novi Sadi.

Ndoshta e rastësishme, hetimet duhet ta tregojnë. Grupi terrorist në arrati i udhëhequr nga Millan Radoičiq po qëndron në Rashkë. Atyre MUP-i famëkeq serb iu ka ndarë vetura të tipit Shkoda Oktavia me ngjyrë të bardhë dhe të zezë e me tabela regjistrimi BG dhe... NS", ka shkruar Kurti në "Facebook".

Kurti ka theksuar se para dy dekadave në Serbi sundonte Klani i Zemunit, kurse tash vendin atij ia ka zënë "Klani i Novi Sadit". "Kriminelë në luftë, kriminelë në paqe; kriminelë në Serbi, kriminelë në Kosovë. Presidenti i shtetit, Aleksandër Vuçiq, pors i një capo-di-tutti-capi, ndodhet aty për të dëshmuar që ndonëse krimi e dikton shtetin, në fakt, është shteti që e dikton krimin", është shprehur Kurti.

Ai ka shtuar se në katër komunat veriore të Kosovës po marrin fund terrori, kriminaliteti dhe kultura e dhunës e paramilitarëve të Delije



(tifoze të Cërvena Zvezdës) që shprehet me nofkat e ekstremistëve si: Mami, Llune, Daco, Rusi, Nemas, Gile, Drago, Aco, Comi, Belli, Micko, Prki, Mrki etj.

"Mirëpo, Kosova nuk ka jurisdikcion në Serbi. A nuk do të duhej që BE-ja dhe ShBA-ja ta formojnë një Gjykatë Speciale për 'Klanin e Novi Sadit'? Mafia ballkanike do të përjetonte goditje

fatale, ndërkaq rajoni i Ballkanit do të hapej i tëri për demokraci evropiane, drejtësi ligjore, paqe të qëndrueshme dhe zhvillim të përshpejtuar", ka pohuar kryeministri Kurti.

## Javë kyçe për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë

PRISHTINË, 23 TETOR - Kjo javë shihet si afati kur Kosova dhe Serbia duhet ta bëjnë hapin kyç në procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve, duke pranuar disa kërkesa dhe propozime që ua kanë paraqitur të shtunën pesë emisarët të lartë perëndimorë.

Kështu pohojnë burimet diplomatike në BE, por pa dhënë hollësi se cilat janë propozimet konkrete që u janë paraqitur kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Megjithatë, thonë se "afati për t'u deklaruar nuk është i gjatë, është shumë i shkurtër, më së largu deri të enjten, kur në Bruksel takohen shefat e shteteve apo qeverive të BE-së në samitin e Këshillit Evropian".

Në një komunikatë të Qeverisë së Kosovës u tha se "të pesë emisarët ofruan planin e tyre të ri për ecjen përpara, për çfarë kryeministri shprehu falënderimet dhe vlerësimet e tij".

As aty nuk u dhanë detaje se për çfarë plani bëhet fjalë. Sipas komunikatës, Kurti tha se prioritet kryesor dhe çështje urgjente për Kosovën është siguria e shtetit dhe e qytetarëve, e kufijve



dhe e territorit.

Kurti edhe Vuçiqi pritet të jenë në Bruksel të enjten dhe, nëse do të ketë përparim nga ta, atëherë në konkluzat e samitit të BE-së pritet të përfshihet një porosi për Kosovën dhe Serbinë dhe procesin e dialogut.

Disa burime diplomatike në Bruksel thonë për "Radion Evropa e Lirë" se kërkesat për Kosovën kanë të bëjnë me pranimin e një drafti për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, ndërsa ato për Serbinë me respektimin pa kushte të obligimeve nga aneksi i pranuar

në Ohër për zbatimin e Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve Kosovë - Serbi.

Të shtunën në Prishtinë dhe Beograd qëndruan përfaqësuesi i posaçëm i BE-së në dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, i dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, përfaqësuesi i lartë i Francës, Emanuel Bonne, i Gjermanisë, Jens Plotner, dhe i Italisë, Alessandro Cattaneo.

Temë diskutimi ishte vazhdimi i dialogut për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi.

Përfaqësuesit e dy vendeve janë takuar për herë të fundit më 14 shtator, por pa ndonjë përparim.

Dhjetë ditë pasi ka ndodhur sulmi në Banjaskë, grupe të armatosura kanë sulmuar policinë e Kosovës, duke vrarë një rreshter.

Kosova ka bërë përgjegjëse Serbinë për këtë sulm dhe ka thënë se nuk do t'u kthehet bisedimeve pa u ndëshkuar shteti fqinj.

Serbia e ka mohuar përfshirjen dhe ka thënë se është duke e hetuar sulmin edhe vetë.

Situata në Kosovë dhe bisedimet e saj me Serbinë janë temë diskutimi edhe në takimin e sotëm të ministrave të Jashtëm të Bashkimit Evropian në Luksemburg.

Për këtë pritet të flasë përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell. Ministrat pritet të njihen edhe me vizitën që pesë përfaqësuesit e lartë perëndimorë kanë zhvilluar në Kosovë dhe Serbi.

Gjatë kësaj jave edhe vetë Lajçaku pritet t'i njoftojë përfaqësuesit e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian për përparimin në këtë proces.

Situata në Kosovë dhe normalizimi i raporteve Kosovë - Serbi ka qenë,

po ashtu, temë e diskutimeve në samitin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian, që është zhvilluar të premten.

Si ShBA-ja ashtu edhe BE-ja kanë bërë thirrje për zbatimin "e shpejtë dhe pa kushte" të Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë si dhe për kthimin e palëve në dialog.

Kosova dhe Serbia janë në bisedime për normalizimin e marrëdhënieve nga viti 2011. Ndonëse kanë arritur dhjetëra marrëveshje, shumë prej tyre kanë mbetur pa u zbatuar.

Ndër pikat më të nxehta të dialogut është Marrëveshja për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

E arritur në vitin 2013, ajo nuk është zbatuar kurrë, pasi zyrtarët në Prishtinë kanë shprehur shqetësimet se kompetencat e gjera për këtë asociacion do të mund të ndikojnë negativisht në funksionalitetin e shtetit. Por, nga ShBA-ja kanë porositur Kosovën se themelimi i këtij asociacioni duhet të jetë ndër hapat e parë që duhet t'i bëjë për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.



# UNDP dhe ICK lansojnë “BOOST II” në mbështetje të bizneseve në Kosovë

PRISHTINË, 23 TETOR - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë ka lansuar edicionin e dytë të Boost x Kosovo për ta mbështetur rimëkëmbjen e gjelbër në sektorin privat.

Ky edicion: Sfida e Gjelbër e Kosovës: NextGen vjen si rezultat i suksesit të edicionit të parë, i cili ka qenë me ndikim të thellë, me mbi 90 % të të pranishmëve që shprehin një rekomandim të fortë për programin. Ky edicion është i fokusuar në Tranzicionin e Gjelbër dhe Digjital të 30 ndërmarjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), nga të cilat 10 do të marrin grante për miratimin e zgjidhjeve të propozuara.

Valët e fundit të të nxehtit dhe përmbytjet e shpejta që ndodhën në Kosovë shërbejnë si një ilustrim

i qartë i ashpërsisë së sfidave të ndryshimeve klimatike, duke krijuar një gamë të gjerë rreziqesh për bizneset dhe veprimtarinë e tyre të përditshme. Për të ndihmuar në adresimin e këtyre tronditjeve mjedisore dhe ekonomike, kjo sfidë e hapur synon t'i përgatisë bizneset për t'u përshtatur me ndikimet e ndryshimeve klimatike duke përhshpejtuar kalimin drejt praktikave të qëndrueshme të biznesit.

Sfida është e hapur për të gjitha NMVM-të që kërkojnë ta forcojnë aftësinë ripërtëritëse të tyre, duke përvetësuar njohuritë dhe financimin e nevojshëm për zgjidhje inovative, të cilat adresojnë krizat mjedisore, ekonomike, sociale dhe shëndetësore. Përqafimi i një

strategjie të rimëkëmbjes së gjelbër jo vetëm që ofron potencial për të krijuar mundësi të reja punësimi dhe për të rindërtuar ekonominë e vendit, por gjithashtu hap rrugën për një të ardhme rezistente ndaj klimës, duke forcuar konkurrencën e Kosovës.

Programi i përhshpejtimit BOOST x Kosova do të përzgjedhë 30 NMVM-të që demonstrojnë potencial të rëndësishëm biznesi për të bërë zhvendosjen drejt qëndrueshmërisë mjedisore si një komponent thelbësor i rimëkëmbjes së gjelbër.

Ky program do të fokusohet në zhvillimin e modeleve të qëndrueshme të biznesit, rritjen e aftësisë të menaxhimit të rrezikut dhe forcimin e qëndrueshmërisë ndaj fatkeqësive. Nëpërmjet

pjesëmarrjes së tyre këto ndërmarje do t'i çojnë zgjidhjet e tyre inovative në nivelin tjetër dhe do ta përforcojnë ndikimin e tyre. NMVM-të e drejtuara nga gratë, të gatshme për të gjeneruar mundësi të konsiderueshme punësimi dhe një të ardhme më të gjelbër, inkurajohen fuqimisht të aplikojnë.

Sfida e Gjelbër e Kosovës është ndër iniciativat e para me fokus të veçantë në fuqizimin e ndërmarrësve të rinj në përpjekjet e tyre, për të kultivuar modele të reja biznesi që i japin përparësi inovacionit, qarkullimit dhe emetimeve zero. Ai synon t'i bashkojë palët e interesuara institucionale, organizatat e shoqërisë civile dhe sektorin privat për t'i mbështetur ndërmarjet mikro, të vogla dhe të

mesme të Kosovës dhe për ta forcuar ekosistemin e inovacionit. Afati i fundit i aplikimit për BOOST II: Sfida e Gjelbër e Kosovës: NextGen është 31 tetor 2023.

BOOST është një program përhshpejtimi, i mundësuar nga UNDP për Evropë dhe Azinë Qendrore, duke rritur inovacionin e ndikimit social dhe duke përhshpejtuar Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. BOOST x Kosova është kapitulli lokal i programit, i nisur nga UNDP në Kosovë dhe i zbatuar në bashkëpunim me Qendrën e Inovacionit në Kosovë (ICK). Edicioni i dytë i tij synon ta mbështesë rimëkëmbjen e gjelbër në sektorin privat duke nxitur një mjedis të favorshëm me një qasje të përqendruar te njerëzit.



## Shtohen eksportet drejt Kosovës, më shumë po shiten materiale ndërtimi, metale dhe ushqime

PRISHTINË, 23 TETOR - Shifrat nga INSTAT tregojnë se për tri vjet mallrat që janë dërguar në Kosovë janë rritur 13 % në vlerë vetëm për periudhën e nëntëmujorit.

Grupi me rritjen më të fortë në tregtinë me Kosovën është ai i materialeve të ndërtimit dhe metaleve. Grupi i dytë është lëndët djegëse, mineralet dhe energjia elektrike. Por, një rritje të fortë ka pësuar edhe grupi i ushqimeve në 9 muajt e fundit duke kaluar i dyti në rend për këtë vit.

Ekspertët shprehin se kjo ka ardhur nga një sërë faktorësh. “Operatorët që punojnë në treg më kanë thënë se janë orientuar



drejt tregjeve që kanë fizibilitet të lartë. Pra në tregun e Kosovës ka mundësi të blesh dhe të shesësh me fitim më të lartë. Kosova,

gjithashtu, ka shumë nevojë sepse ka pasur një bllokim të ndjeshëm të produkteve që vinin nga Serbia dhe sigurisht do të plotësohej nga

Shqipëria dhe, siç thashë, orientimi i biznesit është i tillë që ta gjejë kohën dhe hapësirën e duhur për të përfutur nga tregjet që kanë nevojë për produktet që prodhohen në Shqipëri”, tha Bardh Sejdarasi, gazetar ekonomie.

Një tjetër partner tregtar i rëndësishëm për vendin në tre vitet e fundit është bërë edhe Kina, nga e cila marrim 70 miliardë lekë mallra, gati 32 % më shumë se në 2021-in. Nga krahu tjetër edhe dërgojmë gati 8 % më shumë, kryesisht lëndë të parë. “Ne i kemi tregjet e përcaktuara sa iu përket eksporteve shqiptare nga

produktet që kemi. Mineralet dhe nafta kanë mundësi të shiten jashtë Evropës, në Euroazi dhe me radhë dhe kjo është një lëvizje që orientohet nga bursat e tregut, ajo e hekurit apo mineraleve”, shtoi Sejdarasi.

Për periudhën e nëntëmujorit eksportet ranë 9 %. Kjo ka ardhur si pasojë e zhvlerësimit të euros, uljes së çmimeve në tregjet e huaja për lëndët e para si dhe rënia e kërkesës nga Evropa. Eksportet shqiptare vuajnë edhe nga mungesa e diversifikimit, pasi kryesisht vendi dërgon lëndë të parë dhe jo mallra të përpunuara./tch/

## Rohde: Rrezikohen projekte madhore nga mosmiratimi i marrëveshjeve ndërkombëtare

Prishtinë, 23 tetor - Ambasadori i Gjermanisë në Prishtinë, Jorn Rohde, është shprehur i shqetësuar për mosmiratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në Kuvendin e Kosovës. Rohde tha se janë në

rrezik projektet madhore Gjermani - Kosovë në energjetikë dhe bujqësi. Ambasadori gjerman ka kërkuar qasje konstruktive dhe që opozita “t'i japë fund bllokadës”. “Të shqetësuar për

mosmiratimin e vazhdueshëm të marrëveshjeve ndërkombëtare në Kuvend që mund të sjellin miliona përfitime për qytetarët e Kosovës. Vetëm dypalëshe janë në rrezik projekte të

mëdha energjetike dhe bujqësore Gjermani - Kosovë. Duhet një qasje konstruktive nga të gjithë aktorët. Opozita duhet t'i japë fund bllokadës”, ka shkruar Rohde në “X”.





## A po rikthejnë fuqitë e mëdha, programet e armëve bërthamore?



Tensionet Bërthamore janë shtuar që nga pushtimi i Ukrainës, me Rusinë dhe fuqitë e tjera të armatosura bërthamore që thuhet se përditësojnë vendet e testimit të armëve të papërdorura. Tani, ligjvënësit rusë kanë votuar për të filluar procesin e zhbërjes së një traktati që ndalon teste të tilla. A do të shohim një rikthim të armëve më shkatërruese në botë?

Moratoriumi kundër testeve bërthamore mbështetet në një marrëveshje ndërkombëtare. Traktati i Kufizuar i Ndalimit të Testeve u firmos nga Britania e Madhe, SHBA dhe Bashkimi Sovjetik në vitin 1963, duke ndaluar testimet e këtyre armëve në atmosferë, nën ujë apo në hapësirën e jashtme, por duke lejuar ato nëntokësore. Më pas, në vitin 1996, Traktati Gjithëpërfshirës i Ndalimit të Testeve Bërthamore (CTBT) i

ndaloi teorikisht edhe testimet nëntokësore.

Megjithatë, CTBT është i papërfunduar. Pavarësisht se 178 shtete e kanë ratifikuar, traktati nuk do të hyjë zyrtarisht në fuqi deri sa të veprohet nga tetë vende të tjera. Kina, Egjipti, Irani, Izraeli dhe SHBA kanë firmosur, por e pa ratifikuar marrëveshjen, ndërsa India, Pakistani dhe Koreja e Veriut nuk e firmosën kurrë atë.

Pavarësisht kësaj, ndalimet e testeve bërthamore kanë rezultuar efektive. Më shumë se 2000 teste u bënë midis shpërthimit të parë të SHBA, Trinity, në vitin 1945 dhe hartimit të CTBT. Që atëherë, India dhe Pakistani kryen secila një sërë testesh në vitin 1998, dhe Koreja e Veriut është i vetmi shtet që ka testuar një armë bërthamore në shekullin e 21-të, teksa i fundit u zhvillua në 2017.

Megjithatë, pushtimi rus i Ukrainës dhe lufta e vazhdueshme mund të kenë ndryshuar pikëpamjen e saj për testimin. Rusia ratifikoi CTBT në vitin 2000, por më 17 tetor dhoma e saj e ulët parlamentare, Duma, miratoi një masë për revokimin e ratifikimit. Kryetari i Dumës Vyacheslav Volodin tha se vendimi ishte marrë për shkak se SHBA nuk e ka ratifikuar traktatin dhe “qëndrimin e papërgjegjshëm të SHBA, ndaj çështjeve të sigurisë globale”. Lexime dhe votime të mëtejshme nevojiten për të revokuar zyrtarisht ratifikimin e traktatit nga Rusia dhe pritet që ajo të mbetet nënshkruese tij, por kjo është një tjetër shenjë se vendi mund të rifillojë testimin që përfundoi në 1990, me shpërbërjen përfundimtare të Bashkimit Sovjetik. Në muajt e fundit, Rusia ka testuar sisteme

të reja të shpërndarjes bërthamore – pa koka me mbushje – dhe ka pasur zëra të spikatur brenda vendit që bëjnë thirrje për rifillimin e testeve bërthamore.

Në një fjalim të fundit, presidenti rus Vladimir Putin tha: “Si rregull, thonë ekspertët, me një armë të re, duhet të siguroheni që koka speciale do të funksionojë pa dështime.”

Të tre fuqitë kryesore bërthamore duket se po përgatiten për teste. CNN raporton se zgjerim dhe modernizim ka patur në bazën e testimit të Kinës në rajonin Xinjiang, në atë të Rusisë në një arkipelag të Oqeanit Arktik dhe në vendin e testimit të SHBA në shkretëtirën e Nevadës. Duke folur për CNN, Jeffrey Lewis, i cili punon në Institutin Middlebury të Studimeve Ndërkombëtare në Kaliforni, tha se “ka vërtet shumë tregues

që sugjerojnë se Rusia, Kina dhe Shtetet e Bashkuara mund të rifillojnë testimet bërthamore”.

Edhe pse armët bërthamore janë kthyer në axhendën politike, nuk ka asnjë arsye logjike për të testuar një bombë, thotë Andrew Futter në Universitetin e Leicester. Kjo për shkak se nevoja për të testuar bie, pasi projektimet vërtetohen dhe të dhënat grumbullohen. “Teknologjia ka ndryshuar, por shkencë bazë jo,” thotë ai. Shumica e shteteve të armatosura bërthamore mund të kryejnë simulime kompjuterike për të eksploruar se çfarë do të ndodhë me projektet e reja, thotë ai.

“Problemi është që, ajo që logjika sugjeron se do të ndodhë, ndryshon ndonjëherë nga realiteti,” thotë Futter.

*New Scientist – Bota.al*



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com

# SPORT



## Astana mund të zbarkojë në Kosovë pa lojtarët serbë dhe rusë

ASTANA, 23 TETOR - Astana mund të zbarkojë në Kosovë pa futbollistët e saj serbë dhe rusë. Klubi nga Kazakistani do ta zhvillojë të enjten ndeshjen e vlefshme për fazën e grupeve të Ligës së Konferencës kundër Ballkanit në stadiumin "Fadil

Vokri". Por, ky klub mund të mbërrijë në Prishtinë pa disa prej lojtarëve të rëndësishëm. Këtë e ka bërë të ditur trajneri i ekipit, Grigory Babayan. "E kemi një rrugë të vështirë përpara. Do ta kemi një ndeshje me Ballkanin. Kemi probleme

me fluturimin çarter. Siç e dinë të gjithë, Kosova është një shtet që nuk njihet nga Kazakistani dhe kështu me radhë. Ka vështirësi me hyrjen e lojtarëve rusë dhe serbë. Do të shohim se si do ta zgjidhim këtë. Ne duhet ta rregullojmë logjistikën dhe të

rikuperohemi sa më shpejt të jetë e mundur", ka deklaruar trajneri i Astanas për faqen zyrtare të klubit. Ballkani dhe Astana do të përballen mes vete të enjten në Prishtinë duke filluar nga ora 18:45. Aktualisht kampioni kosovar e sheh veten në pozitën e



dytë në Grupin C me 3 pikë pas dy ndeshjeve të zhvilluara, kurse Astana është e fundit pa pikë.

# 'Ylli i javës' në Superligë, Kryeziu: Mund të arrijmë suksese në Ligën e Konferencës

"Epoka e re"

SUHAREKË, 23 TETOR - Anëtar i FC Ballkani, Almir Kryeziu, e ka rrëmbyer çmimin "Ylli i javës" për xhiron e dhjetë në elitën e futbollit të Kosovës. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga komisioni i veteranëve të futbollit, në përbërje: Skënder Kapra, Luan Tabaku, Fisnik Ademi.

Komisioni e vlerësoi Kryeziun si më të mirin për faktin se ai shënoi dy gola në fitoren e kampionëve në fuqi përballë FC Liria (4-1). Pasi mori këtë çmim sulmuesi u shpreh

i lumtur që u vlerësua kontributi i tij në këtë ndeshje tejet të rëndësishme për ta ruajtur kreun e tabelës. "Jam mirënjohës ndaj Federatës së Futbollit të Kosovës për vlerësimin, po ashtu falënderoj edhe bashkëlojtarët e mi dhe shtabin teknik të Ballkanit për përkushtimin dhe përkrahjen gjatë ndeshjes së fundit. Ishte një përballje e veçantë dhe dëshiroj të theksoj se ishte një sfidë e vështirë për mua dhe skuadrën time, sidomos duke qenë në disavantazh kundër skuadrës së fortë të Lirisë. Gjithashtu, është e rëndësishme të përmend se kjo



ndeshje kishte një ndjenjë të veçantë për mua. Në fakt, kjo ishte emocionale për mua, pasi kam kaluar shumë vite në shkollën e futbollit të Lirisë, ku jam rritur duke kaluar përmes të gjitha grupmohave", ka thënë Kryeziu për faqen zyrtare të FFK-së.

Ai ka folur edhe për sfidën e radhës së portokallezjve në Ligën e Konferencës kundër Astanës. "Ne jemi të gatshëm për këtë sfidë. Do të jemi të përgatitur dhe do ta japim më të mirën tonë në fushë. Kemi një skuadër të fortë dhe besoj se mund të arrijmë suksese në këtë kompeticion", ka shtuar Kryeziu.

# Istogu 'detyrohet' t'i luajë dy ndeshje të EHF European Cup në Sllovaki

ISTOGU, 23 TETOR - Kampioni i Kosovës në hendboll në konkurrencën e femrave, Istogu, po përballlet me vështirësi dhe është e detyruar t'i zhvillojë të dy ndeshjet në Sllovaki. Është hera e parë pas katër viteve Istogu do të zhvillojë ndeshje jashtë vendit. Skuadra e Istogut që nga hapja e Palestrës së Sporteve i ka zhvilluar të gjitha ndeshjet evropiane në Istog për të qenë afër sportdashësve të qytetit të Istogut. Ndeshjen e raundit të dytë këtë vit Istogu e zhvilloi në Pejë dhe u kualifikua në raundin e tretë ku do të takohet me njëri prej skuadrave më të forta të kësaj gare evropiane Juventa nga Sllovakia. Palestra e Sporteve në Istog thuhet se është jashtë funksioni si pasojë e dëmeve të shkaktuara në fillim të vitit e që, fatkeqësisht, nuk janë sanuar kurrë, defekteve të tjera dhe



rekuizitave që nuk janë në përputhje të standardeve evropiane. "Kampionatet në të gjitha sportet janë në vllugun më të madh të garave. Është shumë e vështirë të gjenden terminë në palestra kudo në Kosovë ngaqë

klubet e qyteteve përkatëse kanë ndeshjet e tyre. Istogu është skuadra e vetme në Istog e cila i ka sjellë qytetit trofe, madje jo një, por dhjetëra të tillë. Është kampione e shumëfishtë dhe prej skuadrave më të mira në vendin

tonë, e vetmja skuadër e hendbollit që këtë vit ka arritur ta kalojë raundin në garat evropiane përkundër vështirësive me të cilat po përballlet por që, fatkeqësisht, institucionet komunale dhe ato

qendrore po bëjnë fare pak që skuadrës më të mirë në vend t'i ofrojnë kushtet elementare për zhvillimin e aktiviteteve të klubit dhe përfaqësim të denjë të vendit tonë në Evropë", thuhet në njoftimin e kësaj skuadre.

KHF Istogu pas dy javësh udhëton në Sllovaki për të zhvilluar dy ndeshje atje të raundit të tretë, përkundër sukseseve të arritura në këto rrethana të vështira të krijuara, skuadra nuk ka asnjë lloj mbështetje nga institucionet, qoftë nga komuna e Istogut qoftë nga MKRS-ja. Është vetëm FHK-ja ajo që angazhohet t'i qëndrojë afër skuadrës ashtu si dhe skuadrave të tjera që janë pjesë e saj. Istogu nuk ka ndërmend të ndalet, por do të bëjë çmos ta vazhdojë rrugëtimin e saj prej një skuadre evropiane dhe sukseseve të reja.

## Stadiumi "Ramiz Sadiku" po bëhet me tribunë të re

PRISHTINË, 23 TETOR - Stadiumi "Ramiz Sadiku" në Prishtinë po bëhet me tribunë të re. Me investimin e komunës së Prishtinës tribuna e re e këtij stadiumi do të jetë e përcjell gjithashtu edhe me zyrë për trajnerë, tualete dhe

zhveshtore. Kryetari i komunës së Prishtinës përmes një shkrimi në "Facebook" ka thënë se punimet po bëhen me ritëm shumë të shpejtë me qëllim që sportistët të kenë kushte shumë më të

mira për punë. "Tribuna e stadiumit 'Ramiz Sadiku' po merr formën e saj. Pas përfundimit të punimeve të cilat po bëhen me ritëm të shpejtë, tribuna do të ketë ambiente shumë të përshtatshme për të gjithë, ku

përfshihen zyrat për trajnerët, zhveshtorja dhe tualetet super moderne. Me këtë investim ne po u ofrojmë hapësira të mjaftueshme e të mira sportistëve, klubeve e sportdashësve", ka shkruar Rama.





## Në janar vendoset e ardhmja e Brojës

LONDËR, 23 TETOR - Më 12 pikë në 9 javë, Chelsea vijon të lundrojë në ujëra të turbullta, në vendin e 10 në Premierë Ligë. "Blutë" ngecën në një barazim 2-2 në derbi përballë Arsenal, por pika e marrë i rri ngushtë pasi ishin në epërsi të dyfishtë. Nuk ishte në dispozicion të trajnerit

Pochettino sulmuesi kuqezi Armando Broja. Mungesa e tij u dha fund thashethemeve që flisnin për një krisje mes tij dhe trajnerit Sylvinho. "Bomberi" shqiptar vijon të mos jetë në kushte të përkryera, ndërsa e ardhmja e tij te Chelsea vihet edhe një herë në dyshim. Broja mbetet një emër fiks në tregun

e transferimeve, e kërkojnë disa ekipe në Premierë Ligë, por edhe në Serinë A, ku Interi dhe Milani e ndjekin prej kohësh. E ardhmja e Brojës është në dorë të trajnerit Pochettino pasi, sipas medieve angleze, tekniku argjentinas do të ketë fuqi absolute në merkaton e janarit. "Mirror" shkruan se drejtuesit e

klubit londinez, pavarësisht se kanë shpenzuar shifra marramendëse, do të jenë sërish aktiv në merkaton e janarit. Një prej dilemave kryesore të Pochettinos do të jetë edhe Broja, ta mbajë në skuadër apo ta pranojë ofertën e ndonjë klubi për ta marrë në formë huazimi pasi shitja e tij



## Sarah Mgbeike, MVP e javës së tretë

PRIZREN, 23 TETOR - Alo-qendra Sarah Mgbeike është shpallur MVP e javës së tretë pasi ishte një nga më meritoret e fitores së Bashkimit ndaj Peja 03. Mgbeike shënoi 21 pikë, 9 kërcime si dhe 4 asistime. Peja 03-Bashkimi ishte derbi i xhiros së tretë, ku fitues ishte Bashkimi me rezultat 71:77. Bashkimi ka arritur tri fitore në tri ndeshje, kurse Peja 03 ka shënuar një fitore në tri ndeshje. Kësaj fitore më së shumti i kontribuoi Sarah Mgbeike e cila shënoi 21 pikë, 9 kërcime dhe 4 asistime. Në top 5 e kësaj jave Aulona Muhadri është lojtarja e vetme vendor e cila ndihmoi skuadrën me 17 pikë, 6 kërcime dhe 1 asistim. Ndeshje interesante u zhvillua edhe në kryeqytet ku Prishtina fitoi bindshëm ndaj Penzës me rezultat 84:48. Për këtë fitore të Prishtinës dyshja Williams dhe Johnson shkëlqyen në parket. Jade Williams shënoi 19 pikë, 10 kërcime dhe 3 asistime, kurse Asianae Johson shtoi 17 pikë, 5 kërcime dhe 7 asistime. Ndeshja e



fundit e kësaj xhiroje u zhvillua në Gjilan në mes të United Basketball dhe Trepça e cila përfundoi me rezultat të thellë 50:105. Sa arriti të shënonte United Basketball, shënoi

vetëm basketbollistja e Trepçës, Mar'shay Moore 50 pikë, 6 kërcime e 9 asistime, e cila u ndihmua nga Jessica Wilson me 27 pikë, 6 kërcime dhe 4 asistime.

## Fury para një viti paralajmëronte tërheqjen, tash synon t'i zhvillojë edhe 10 duele

WYTHENSHAW, 23 TETOR - Tyson Fury ka larguar frikën se përballjet e ardhshme kundër Francis Ngannou dhe Oleksandr Usyk do të jenë të fundit për të. 35-vjeçari do të duelojë këtë fundjavë me ish-kampionin e peshave të rënda të UFC, në Arabinë Saudite, pak më shumë se një vit pasi njoftoi tërheqjen e tij të dytë nga sporti. Kjo ndërprerje zgjati vetëm katër muaj përpara se ai të kthehej për të luftuar Derek Chisora në dhjetor 2022. Fury tani jo vetëm që ka zbuluar se nuk ka ndërmend ta ngadalësojë ritmin por, në fakt, po synon një marrëveshje me shumë duele të shumëpritura. "Po kërkoj të nënshkruaj një marrëveshje tjetër me 10 duele në ring pas kësaj që do të zhvilloj ditën e shtunë. Pra, do t'i



vendos ndjenjat e mia atje dhe do të shoh se kush mund ta marrë marrëveshjen më të mirë për 10 ndeshje të tjera", ka thënë Fury për ESPN. "Kjo më bën të jem i lumtur duke luftuar. Kjo është gjithçka që

kam bërë ndonjëherë dhe gjithçka që më ka bërë ndonjëherë të lumtur. Kështu që, do të ishte marrëzi tani të largohesha prej saj kur po fitoj miliona dollarë dhe po marr shumë gëzim nga ajo", u shpreh Fury.

### SHKURT

#### Pioli: Edhe me 10 lojtarë nuk ishim inferiorë ndaj Juventusit

Trajneri i AC Milanit, Stefano Pioli, ka thënë se kuqezinjtë nuk ishin inferiorë në asnjë çast ndaj Juventusit, ani se ishin me një lojtar më pak që nga minuta 40, kurse Malick Thiaw u përjashtua me karton të kuq. "Nuk ishte rezultati që donim, por ne luajtëm mirë me 11 lojtarë, luajtëm mirë me 10 lojtarë dhe nuk ishim në asnjë pikë inferiorë ndaj Juventusit, kështu që mendoj se mund të kishim marrë rezultatin", u shpreh Pioli, i cili për kartonin e kuq deklaroi se ishte një gabim naiv, si individual ashtu edhe i ekipit. "Pjesa e dytë filloi mjaft mirë, por më pas na mungoi pak intensiteti mbi të gjitha në mesfushë. Është gjithashtu e vërtetë që ne i lejuam Juventusit pothuajse asnjë shans, kështu që me pak më shumë intensitet ndiej se mund të kishim marrë në shtëpi një rezultat shumë të rëndësishëm edhe deri në 10 lojtarë", ka shtuar Pioli.

#### Verstappen triumfon edhe në Grand Prixin e Amerikës

Garuesi i Red Bullit në Formula 1, Max Verstappen, e ka siguruar fitoren e 50 në karrierë, pasi triumfoi në Grand Prixin e Amerikës. Ndonëse Land Norris i McLarenit e nisi më mirë garën, duke udhëhequr. Primatin më pastaj e mori kampioni Verstappen, duke u shtyrë deri në fund me Lewis Hamiltonin, i cili u rendit në pozitën e dytë. Në pozitën e tretë doli Norris, teksa në vendin e katërt Carlos Sainz. Në top pesëshen ishte Sergio Perez, piloti i Ferrarit. Përndryshe, Verstappeni tashmë është shpallur kampion në Formula 1, ani se ka ende ka gara për të zhvilluar.

#### Xavi: Tash duhet ta mposhtim edhe Realin

Barcelona e mposhti me rezultat minimal Bilbaon (1-0), derisa më 26 tetor do të përballlet me Real Madridin në "El Clasico". Trajneri Xavi Hernandez është shprehur se skuadra e tij duhet ta shfrytëzojë terrenin vendas dhe ta mposhtë rivalin më të madh, Realin e Madridit. "Klasikja' është një ndeshje shumë e rëndësishme për ne, por mos harroni se në mes kemi Ligën e Kampioneve. Kjo garë është shumë e rëndësishme por, për fat të keq, kemi shumë mungesa si pasojë e dëmtimeve. Ia kemi dalë me një sforcë titanike kundër Bilbaos, por është shumë e rëndësishme që i kemi marrë dy pikë Realit dhe tani të shkojmë ta fitojmë 'El Clasico', sepse luajmë në fushën tonë", ka thënë Xavi.

#### Goretzka mungon tri javë

Leon Goretzka do t'i mungojë disa javë Bayern Munchenit. E përditshmja "Bild" raporton se mesfushori 28-vjeçar ka thyer një nga gishtat e dorës së majtë në ndeshjen ndaj Mainzit. Lojtari doli nga fusha i dëmtuar, me dhimbje të mëdha në dorën e majtë. Më pas, pas një grafie që konfirmoi dëmtimin, lojtari iu nënshtrua një operacioni të vogël në dorë. Goretzka do të qëndrojë të paktën tri javë, duke humbur disa ndeshje në kampionat dhe Ligën e Kampioneve. Stafu mjekësor do të provojë ta rikuperojë lojtarin për ndeshjen ndaj Borussia Dortmundit më 4 nëntor.

## Allegri: Nuk jemi favoritë për titullin, tri skuadra janë para nesh

Juventusit shënoi fitore në derbin e Italisë ndaj Milanit (0-1). Një gol i Manuel Locatellit ka vendosur sfidën duke i dhënë tri pikë të arta "Zonjës së Vjetër" në "San Siro". Trajneri i Juventusit, Massimiliano

Allegri, nuk e sheh skuadrën e tij si favorite për titullin e kampiones në Serinë A. Ai insiston se para Juventusit si favoritë janë Interi, Milani dhe kampioni në fuqi, Napoli. "Interi, Milani dhe Napoli janë

favoritët për titullin, një ndeshje nuk ndryshon asgjë. Ne duhet të kthehemi për të luajtur në Ligën e Kampioneve. Ishte një ndeshje e luajtur mirë në mbrojtje në pjesën e parë, pastaj futbollit përbëhet nga

episode dhe pati një paraqitje të mirë nga Kean", ka thënë Allegri. "E nisëm pjesën e dytë jo shumë mirë, edhe pse ishim në epërsi numerike, duke pësuar disa harkime, për më tepër fundi duhej menaxhuar

më mirë, për të mos e lejuar Milanin të kundërsulmonte, sepse Leao është në gjendje ta zhvlerësojë lojtarin plus. Unë jam shumë i lumtur. Duhet t'i falënderoj djemtë", ka deklaruar Allegri.





Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A  
Kosova Landfill Management Company J.S.C  
Rr.Bekim Fehmiu 137,Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552  
www.kmdk-ks.org

## KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 03/L-212 i Punës konkretisht Neni 8, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, bazuar në Rregulloren Nr. 27/2023 për Ndryshim Plotësimin e Rregullores nr.23/2020 për Procedurat e Punësimit, Strukturën Organizative, Kategorizimin dhe Përshkrimin e vendeve të punës në KMDK SH.A dhe bazuar në Vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv të KMDK SH.A me Nr.127/2023 te dt.20.10.2023 me nr. të protokolit 02-07/127, KMDK SH.A shpall këtë:

### KONKURS PUBLIK

(PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS)

**Titulli: – Inxhinier 4 ( katër ) Pozita**

**Numri i Referencës: ZP/KJ-12-2023**

**I raportojnë: Drejtorit të Operativës**

**Niveli i pagës: Niveli IV**

**Orët e Punës: 40 orë në javë**

**Kohëzgjatja e kontratës: Me kohë të caktuar (1 vit) me mundësi vazhdimi**

**Vendi i punës: KMDK-së SH.A**

#### Detvat dhe Përgjegjësitë

- Harton Planifikimet mujore dhe vjetore profesionale;
- Merr pjesë në hartimin e dizajnit të projekteve investuese për ndërtimin dhe zgjerimin e deponive sanitare;
- Përpilon specifikimet teknike si dhe kryen monitorimin e ekzekutimeve të punimeve inxhinierike;
- Bën mbikëqyrjen e realizimit të punimeve në përputhje me kërkesat e projektit ose sipas udhëzimeve të eprorit të drejtpërdrejtë;
- Merr pjesë në hartimin e planifikimeve buxhetore sipas kërkesave të punëdhënësit;
- Përcjellë punët në procesin e menaxhimit, operimit dhe të mirëmbajtjes së deponive sanitare/stacionin e transferit;
- Merr pjesë në koordinimin dhe menaxhimin e zbatueshmërisë së projekteve, investimeve kapitale;
- Jep këshilla dhe udhëzime profesionale për zgjidhjet më të favorshme teknike e funksionale gjatë procesit të operimit të deponive sanitare/ stacionit të transferit;
- Bashkërendon aktivitetet operative në deponitë sanitare dhe stacionin e transferit në bashkëpunim me Drejtorin e Operativës apo eprorit të drejtpërdrejtë;
- Përgatitë raportet mujore/vjetore dhe sipas kërkesës së Drejtorisë Operative;
- Inxhinieri për punën e vet i përgjigjet drejtpërdrejtë Drejtorit të Operativës, sipas nevojës edhe Kryeshefit Ekzekutiv.

#### Kualifikimet dhe përvoja e punës

- Diplomë Universitare, Fakulteti i Ndërtimtarisë (Konstruktiv, Hidroteknikë), Arkitekturë apo fakultete të ngjashme të Inxhinierisë Civile/Teknike;
- Përvojë pune së paku 3 (tre) vite, në fushën e ndërtimtarisë (infrastrukturë) apo të Inxhinierisë civile;

#### Aftësitë kryesore

- Të ketë shkathësi në përdorimin e kompjuterit, janë të nevojshme programet (Autocad, Archicad, Civil Engineering Design), dhe programe të ngjashme etj;
- Të ketë gatishmëri për punë ekipore;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi;
- Njohja e gjuhëve të huaja (angleze);

#### Procedura e konkurrimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyrë e Burimeve Njerëzore të KMDK SH.A apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën: <https://kmdk-ks.org/>. Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në zyrë e Burimeve Njerëzore në adresën: Rruga “Bekim Fehmiu” Nr. 137, 10000 Prishtinë, Kosovë (Afër Shkollës Shtjefën Gjeçovi), Lakrishtë. Tel: 038/ 600 – 552.

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

#### Dokumentacioni i nevojshëm:

- Aplikacioni
- CV,
- Diploma,
- Certifikatat mbi kualifikimet dhe trajnimet,
- Dëshmi mbi përvojën në punë, si dhe dëshmi të tjera në bazë të kualifikimit dhe aftësive.
- Certifikatë nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i/e dënuar për kryerjen e ndonjë veprë penale (jo më vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit)

**Shënim:** Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pa kompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

Afati për aplikim është 15 ditë nga dita e publikimit të Konkursit të Jashtëm në Gazetat/Platformat Elektronike dhe Web-Faqe të KMDK-së, duke filluar nga data: 24.10.2023 deri me datën 07.11.2023 ora 08:00-16:00.

**Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Zyrën e Burimeve Njerëzore të KMDK SH.A**

Email: [info@kmdk-ks.org](mailto:info@kmdk-ks.org)

Tel: 038/ 600 – 552.



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A  
Kosova Landfill Management Company J.S.C  
Rr.Bekim Fehmiu 137,Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552  
www.kmdk-ks.org

## KOMPANIJA ZA UPRAVLJANJE SKLADIŠTIMA NA KOSOVOU dd

Na osnovu Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća, Zakon br. 03/L-212 o radu, konkretno član 8, na osnovu Administrativnog uputstva (MPMS) br. 07/2017 za regulisanje postupaka konkurencije u javnom sektoru, na osnovu Uredbe br. 27/2023 o izmjeni i dopuni Uredbe br.23/2020 o postupku zapošljavanja, organizacionoj strukturi, kategorizaciji i opisu poslova u KMDK S.A. a na osnovu Odluke glavnog izvršnog direktora KMDK S.A. broj 127/ 2023 od 0. 2023 sa br. protokola 02-07/127 KMDK dd saopštava:

### JAVNI KONKURS

(ZA POPUNJAVANJE RADNIH MJESTA)

**Titula: - Inženjer 4 ( četiri ) pozicija**

**Referentni broj: ZP/KJ-12-2023**

**Oni odgovaraju: Direktor operacija**

**Nivo plata: Nivo IV**

**Radno vrijeme: 40 sati sedmično**

**Trajanje ugovora: Na određeno (1 godina) sa mogućnošću produženja**

**Mjesto rada: KMDK dd**

#### Dužnosti i odgovornosti

- Izrađuje mjesečne i godišnje stručne planove;
- Učestvuje u izradi i projektovanju investicionih projekata za izgradnju i proširenje sanitarne deponije;
- Sastavlja tehničke specifikacije kao i prati izvođenje radova inženjering;
- Nadzire izvođenje radova u skladu sa zahtjevima projekta ili prema direktne instrukcije prepostavljenog;
- Učestvuje u izradi planova budžeta prema zahtevima poslodavca;
- Izvođenje radova u procesu upravljanja, eksploatacije i održavanja deponija sanitarna/transfer stanica;
- Učestvuje u koordinaciji i upravljanju primenjivosti projekata, investicija kapital;
- Daje stručne savjete i upute za najpovoljnija tehnička rješenja e funkcionalan tokom procesa rada sanitarne deponije/transfer stanice;
- Koordinira operativne aktivnosti na sanitarnom depou i transfer stanici saradnja sa operativnim direktorom ili direktnim nadređenim;
- Priprema mjesečne/godišnje izvještaje i prema zahtjevu Operativne uprave;
- Inženjer za svoj rad odgovara direktno direktoru operacija po potrebi i glavni izvršni direktor.

#### Kvalifikacije i radno iskustvo

- VSS, Građevinski fakultet (Građevinski, Hidrotehnički), Arhitektonski ili slični građevinsko-tehnički fakulteti;
- Radno iskustvo od najmanje 3 (tri) godine, u oblasti građevinarstva (infrastrukture) ili niskogradnje;

#### Ključne vještine

- Za poznavanje rada na računaru neophodni su programi (Autocad, Archicad, Građevinarstvo) i slični programi i dr.;
- Spremnost za timski rad;
- Imaju dobre komunikacijske vještine;
- Poznavanje stranih jezika (engleski);

#### Konkursna procedura

Zainteresovani kandidati mogu dobiti zvanični formular u kancelariji za ljudske resurse KMDK SH.A ili ga preuzeti sa web stranice na adresi: <https://kmdk-ks.org/>. Dokumentacija se može dostaviti u fizičkoj kopiji kancelariji za ljudske resurse na adresi: ulica „Bekim Fehmiu“ br. 137, 10000 Prishtina, Kosovo (blizu škole Shtjefën Gjeçovi), Lakrishtë. Telefon: 038/ 600 – 552.

Kandidati koji se takmiče moraju ispravno unijeti adresu, kontakt telefon i email adresu. Samo odabrani kandidati će biti pozvani na dalje procedure zapošljavanja.

#### Potrebna dokumentacija:

- Aplikacija
- ŽIVOTOPIS,
- Diploma,
- sertifikate o kvalifikacijama i obuci,
- Dokaz o radnom iskustvu, kao i drugi dokazi na osnovu kvalifikacija i vještina.
- Uvjerjenje nadležnog suda da se ne vodi krivični postupak i da nije osuđivan za neko krivično djelo (ne starije od 6 (šest) mjeseci od dana izdavanja)

**Napomena:** Prijave poslate poštom, koje su obilježene poštanskim žigom posljednjeg dana roka za prijavu, smatrat će se valjanim i bit će uzete u obzir ako stignu u roku od tri (3) dana. Prijave koje pristignu nakon ovog roka i one koje nisu kompletirane sa odgovarajućom dokumentacijom neće se razmatrati.

Rok za prijavu je 15 dana od dana objavljivanja Eksternog konkursa unovinama/elektronskim platformama i web stranicama KMDK, počev od: 24.10.2023. do 07.11.2023. godine, 08:00-16:00 časova.

Za detaljnije informacije možete se obratiti Službi za ljudske resurse KMDK SH.A

Email: [info@kmdk-ks.org](mailto:info@kmdk-ks.org)

Telefon: 038/ 600 – 552.





Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe Vendimit Nr. 3533, të datës 24.10.2023, Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" SH.A në Prishtinë, shpall këtë:

### KONKURS

**Titulli i pozitës:** Arkatar/e – 1 pozitë

**Institucioni:** Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" SH.A – Prishtinë

**Titulli i Mbikëqyrësit:/Raporton tek:** Shefi i Kontabilitetit

**Orari i Punës:** 40 orë në javë

**Kohëzgjatja e emërimit:** me afat të pacaktuar

**Detyrat dhe përgjegjësitë:** (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore)

- Bën pranimin e pagesave të bëra nga inkasatët dhe portoarkat;
- Bën deponimin e mjeteve në xhirollogaritë bankare të Kompanisë;
- Bën regjistrimin e të hyrave dhe të dalurave përmes ditarit të arkës për secilën ditë të punës;
- Përcjell salldon e arkës dhe e bën transferin e mjeteve përmes bankave, transferin e mjeteve për pagat e punëtorëve, e pranon raportin (gjendjen) e xhirollogarive të ndërmarrjes dhe e bën pagesën e faturave përmes arkës deri në maksimumin e lejuar;
- Materialisht është përgjegjës për të hollat dhe letrat me vlerë me të cilat disponon;
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit të drejtëpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj i përgjigjet Shefit të Kontabilitetit dhe ZKF-së;

**Shkathtësitë e kërkua:** (aftësitë dhe shkathtësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale nga fusha ekonomike; Njohuri e gjuhës angleze e preferueshme;
- Njohuri me aftësi të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point etj) dhe internetin;
- Shkathtësi për shqyrtimin e lëndëve apo shkresave të ndryshme të punës së përditshme të ndërmarrjeve;
- Shkathtësi hulumtuuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion.

**Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës:** (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diplomë e shkollës së mesme;
- Një (1) vit përvojë pune;

**Konkursi është publikuar më datë 24 tetor 2023 dhe mbyllet më datë 07 nëntor 2023.**

**APLIKACIONI:** Në aplikacion duhet të bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurim, siç janë:

1. Dëshminë e kualifikimit shkollor;
2. Dëshmi mbi përvojën e punës (*Vërtetimi ose kontrata e punës*);
3. Dy rekomandime (*nëse kenë*);
4. Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (*nëse ekzistojnë të tilla*);
5. Dokumentin e identifikimit–letërnjoftimi i fotokopjuar;
6. Çertifikata nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.

#### **MËNYRA E APLIKIMIT:**

Formulari i aplikacionit merret dhe dorëzohet në pliko (zarfë) të mbyllur në arkivën e KRM "Pastrimi" SH.A, Rr. "Tahir Zajmi", Nr.5, Prishtinë.

Aplikimi përmes postës: Aplikacioni i kompletuar me dokumente mund të dorëzohet edhe përmes postës në adresën: Rr. "Tahir Zajmi", nr.5, Prishtinë, 10000. Aplikacionet e dërguara me postë duhet të mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 3 tri ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara, nuk do të shqyrtohen fare.

#### **KUSHTET E PJESËMARRJES NË KONKURS:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

KRM "Pastrimi" SHA ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

#### **VËREJTJE:**

**APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËREKSIVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË KONKURS SI DHE ATO QË ARRINË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHOYRTOHEN.**

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit. Për informata më të rëndësishme mund të kontaktoni në nr. tel: +383 (0) 38 603 191



Na osnovu zakona br. 03/L-212 rada, administrativno uputstvo br.07/2017 o regulisanju postupka konkurencije u javnom sektoru i odluka br. 3533, od 24.10.2023. godine, Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" SH.A kuranu izjavljuju:

### KONKURS

**Naslov pozicije:** Archaeman – 1 pozicija

**Institucija:** Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" SH.A – Priština

**Nadzorni naslov:** Izveštaj: Glavni računovođa

**Radno vreme:** 40 sati nedeljno

**Trajanje zakazane obaveze:** neodređeno vreme

**Dužnosti i odgovornosti:** (kratak opis glavnih zadataka)

- Prihvatite uplate od strane Inkasanta i orangearchsa;
- Uplaćuj sredstva na bankovne račune kompanije;
- Registruje prihode i prihode putem evidencije čekovne knjiziće za svaki radni dan;
- Pratite blagajnu i prenosite sredstva preko banaka, prebacite sredstva za zarade zaposlenih, prihvatite izveštaj (status) računa preduzeća i izvršite plaćanje računa kroz blagajnu do maksimalno dozvoljenog;
- Materijalno odgovoran za novac i hartije od vrednosti sa kojima ga ima;
- A onda rade druge stvari po zapovesti direktnog vodiča.
- Za svoj rad odgovara šefu računovodstva i NSA;

**Potrebne su veštine :** (potrebne veštine i veštine za ovaj posao)

- Odlično profesionalno znanje iz ekonomske oblasti; Poželjno znanje engleskog jezika;
- Znanje sa dobrim radnim veštinama na računaru sa apli programima (Microsoft Word, Excel, Power Point itd.) i Internetom;
- Sposobnost preispitivanja različitih predmeta ili papirologije svakodnevnog rada preduzeća;
- Istraživanje, analitičko, vrednovanje i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- Sposobnost održavanja kvaliteta rada čak i pod pritiskom.

**Kvalifikacije za obrazovno, profesionalno i radno iskustvo:** (kvalifikacije i iskustvo potrebno za ovaj posao)

- Diploma srednje škole;
- Jedna (1) godina radnog iskustva;

**Konkurs je objavljen 24 oktobra 2023 godine, a zatvoren je 07 novembra 2023 godine.**

**Prijava:** Prijava mora da sadrži potrebna dokumenta za konkurs, kao što su:

1. Dokaz o školskim kvalifikacijama;
2. Dokaz o radnom iskustvu (*dokaz o zaposlenju ili ugovoru*);
3. Dve (*ako imate*) preporuke.
4. Kopije poslednja dva uzastopna izveštaja o proceni rada (*ako takvi postoje*);
5. Identifikacioni dokument–fotokopiranu identifikacionu karticu;
6. Potvrde od suda da niste pod istragom.

#### **REŽIM APLIKACIJE:**

Prijavni formular se uzima i podnosi u zatvorenoj koverti u arhivi KRM "Pastrimi" SH.A, "Tahir Zajmi" St., br.5, Priština.

Prijava poštom: Prijava kompletna sa dokumentima može se podneti i poštom na adresu: "Tahir Zajmi" St., br.5, Priština, 10000. Prijave poslate putem pošte treba da zadrže žig na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu. Prijave poslate putem pošte, koje nose poštansku marku na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu, smatraće se važećim i biće razmotrene ukoliko stignu u roku od 3 tri dana. Prijave koje stignu posle ovog roka i nekomplikovane uopšte neće biti razmatrane.

#### **USLOVI UČEŠĆA NA KONKURSU:**

Pravo na primenu imaju svi građani Republike Kosovo starosne dobi većine koji imaju punu sposobnost da deluju, poseduju građanska i politička prava, poseduju neophodnu obrazovnu pripremu i stručnu sposobnost obavljanja zadataka i koji poseduju fizičke veštine potrebne za obavljanje odgovarajućeg položaja.

KRM "Čišćenje" AD nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja prijave svih muških i ženskih osoba iz svih zajednica na Kosovu.

#### **UPOZORENJE:**

**PRIJAVE I NEKOMPATIBILNA DOKUMENTACIJA PREMA ZAHTEVIMA NAVEDENIM NA OVOM KONKURSU I ONIMA KOJI STIGNU PO ISTEKU ROKA KONKURSA NEĆE BITI RAZMATRANI.**

Biće kontaktirani samo kandidati koji su ušli u uži izbor.

Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja. Za više informacija možete nas kontaktirati na br. Tel: +383 (0) 38 603 191





Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" SH.A në Prishtinë, shpall këtë:

## KONKURS

**Titulli i pozitës:** Asistent Ekzekutiv i Kryeshefit Ekzekutiv – 1 pozitë

**Institucioni:** Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" SH.A – Prishtinë

**Titulli i Mbikëqyrësit:/Raporton tek:** Kryeshefi Ekzekutiv

**Orari i Punës:** 40 orë në javë

**Kohëzgjatja e emërimit:** me afat të pacaktuar

**Detyrat dhe përgjegjësitë:** (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore)

- Mban shënime dhe përgatitë renditjen (agjendën) e takimeve ditore të KE;
- Evidenton shkresat dhe i përcjell ato të KE;
- Pret palët dhe evidencon kërkesat e tyre;
- Punon me kompjuter për nevojat e KE;
- Mban evidencë të shkresave të cilat i dërgohen KE për nënshkrim
- Kryen punë dhe detyra të tjera të cilat i caktohen nga KE.

**Shkathtësitë e kërkuara:** (aftësitë dhe shkathtësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse të administratës;
- Njohuri me aftësi të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point etj) dhe internetin;
- Aftësi për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion.

**Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës:** (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diplomë Universitare;
- Një (1) vit përvojë pune profesionale;

**Konkursi është publikuar më datë 24 tetor 2023 dhe mbyllet më datë 07 nëntor 2023.**

**APLIKACIONI:** Në aplikacion duhet të bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurim, siç janë:

1. Dëshminë e kualifikimit shkollor;
2. Dëshmi mbi përvojën e punës (*Vërtetimi ose kontrata e punës*);
3. Dy rekomandime (*nëse keni*);
4. Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (*nëse ekzistojnë të tilla*);
5. Dokumentin e identifikimit-letërnjoftimi i fotokopjuar;
6. Çertifikata nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.

### **MËNYRA E APLIKIMIT:**

Formulari i aplikacionit merret dhe dorëzohet në pliko (zarfë) të mbyllur në arkivën e KRM "Pastrimi" SH.A, Rr. "Tahir Zajmi", Nr.5, Prishtinë.

Aplikimi përmes postës: Aplikacioni i kompletuar me dokumente mund të dorëzohet edhe përmes postës në adresën: Rr. "Tahir Zajmi", nr.5, Prishtinë, 10000. Aplikacionet e dërguara me postë duhet të mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 3 tri ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara, nuk do të shqyrtohen fare.

### **KUSHTET E PJESËMARRJES NË KONKURS:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

KRM "Pastrimi" SHA ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëprehet aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

### **VËREJTJE:**

**APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËREKSIVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË KONKURS SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHQYRTOHEN.**

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit.

Për informata më të rëndësishme mund të kontaktoni në nr. tel: +383 (0) 38 603 191



Prema članu 8. Zakona br. 03/L-212 rada, član 4 Upravnog uputstva br.07/2017 o regulisanju postupka konkurencije u javnom sektoru, Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" SH.A kurano izjavljuje:

## KONKURS

**Zvanje pozicije:** Izvršni pomoćnik glavnog izvršnog direktora – 1 pozicija

**Institucija:** Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" SH.A – Prishtina

**Nadzorno zvanje:** Izveštaj: Glavni izvršni direktor

**Radno vreme:** 40 sati nedeljno

**Trajanje zakazane obaveze:** neodređeno vreme

**Dužnosti i odgovornosti :** (kratak opis glavnih zadataka)

- On vodi evidenciju i priprema listu dnevnih sastanaka EK;
- Onda ćete primetiti i pratiti ih.
- Čekaju i čekaju svoje zahteve.
- Radi sa računarima za potrebe EK;
- Vodi evidenciju o pismima poslatim EK radi potpisa
- Obavlja druge zadatke i zadatke koje im je dodelila EK.

**Potrebne su veštine :** (potrebne veštine i veštine za ovaj posao)

- Odlično poznavanje administracije;
- Poznavanje dobrih veština rada na računaru pomoću aplita programa (Microsoft Word, Excel, Power Point itd.) i Interneta;
- Sposobnost održavanja kvaliteta rada čak i pod pritiskom.

**Kvalifikacije za obrazovno, profesionalno i radno iskustvo:** (kvalifikacije i iskustvo potrebno za ovaj posao)

- Univerzitetska diploma;
- 1(1) godina profesionalnog iskustva;

**Konkurs je objavljen 24 oktobra 2023 godine, a zatvoren je 07 novembra 2023 godine.**

**Prijava:** Prijava mora da sadrži potrebna dokumenta za konkurs, kao što su:

1. Dokaz o školskim kvalifikacijama;
2. Dokaz o radnom iskustvu (*dokaz o zaposlenju ili ugovoru*);
3. Dve (*ako imate*) preporuke.
4. Kopije poslednja dva uzastopna izveštaja o proceni rada (*ako takvi postoje*);
5. Identifikacioni dokument–fotokopiranu identifikacionu karticu;
6. Potvrde od suda da niste pod istragom.

### **REŽIM APLIKACIJE:**

Prijavni formular se uzima i podnosi u zatvorenoj koverti u arhivi RM "Pastrimi" SH.A, "Tahir Zajmi" St., br.5, Prishtina.

Prijava poštom: Prijava kompletna sa dokumentima može se podneti i poštom na adresu: "Tahir Zajmi" St., br.5, Prishtina, 10000. Prijave poslate putem pošte treba da zadrže žig na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu. Prijave poslate putem pošte, koje nose poštansku marku na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu, smatraće se važećim i biće razmotrene ukoliko stignu u roku od 3 tri dana. Prijave koje stignu posle ovog roka i nekomplikovane uopšte neće biti razmatrane.

### **USLOVI UČEŠĆA NA KONKURSU:**

Pravo na primenu imaju svi građani Republike Kosovo starosne dobi većine koji imaju punu sposobnost da deluju, poseduju građanska i politička prava, poseduju neophodnu obrazovnu pripremu i stručnu sposobnost obavljanja zadataka i koji poseduju fizičke veštine potrebne za obavljanje odgovarajućeg položaja.

KRM "Pastrimi" Sh.A nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja prijave svih muških i ženskih osoba iz svih zajednica na Kosovu.

### **UPOZORENJE:**

**PRIJAVE I NEKOMPATIBILNA DOKUMENTACIJA PREMA ZAHTEVIMA NAVEDENIM NA OVOM KONKURSU I ONIMA KOJI STIGNU PO ISTEKU ROKA KONKURSA NEĆE BITI RAZMATRANI.**

Biće kontaktirani samo kandidati koji su ušli u uži izbor.

Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja.

Za više informacija možete nas kontaktirati na br. Tel: +383 (0) 38 603 191





Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" SH.A në Prishtinë shpall këtë:

## KONKURS

**Titulli i pozitës:** Punëtor fizik – 5 pozita

**Institucioni:** Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" SH.A – Prishtinë

**Titulli i Mbikëqyrësit/Raporton tek:** Kryepunëtori

**Orari i Punës:** 40 orë në javë

**Kohëzgjatja e emërimit:** me afat të pacaktuar

**Detyrat dhe përgjegjësitë:** (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore)

- Kryen të gjitha punët fizike në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave, zbrastjen e kontenjerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre;
- Sipas planit operativ dhe urdhërësës së punës bën fshirjen/pastrimin dhe larjen e rrugëve apo pastrimin e rrugës dhe trotuareve nga bora dhe akulli, hudhjen e kripës;
- Bën largimin e qenve dhe maceve të ngordhura dhe vendosjen e tyre në kontenjer;
- Është i obliguar që të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve;
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të kontenjerëve dhe mjeteve të punës;
- Kryen dhe punë të tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit.

**Shkathësitë e kërkuara:** (aftësitë dhe shkathësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Shkathësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Aftësi bashkëpunimi, ndërpersonale si dhe pune në grup;

**Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës:** (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diploma e shkollës fillore;

**Konkursi është publikuar më datë 24 tetor 2023 dhe mbyllet më datë 07 nëntor 2023.**

**APLIKACIONI:** Në aplikacion duhet të bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurim, siç janë:

1. Kopja e letërnjoftimit;
2. Kopja e diplomës të shkollës fillore
3. Çertifikata e lindjes
4. Vërtetim që nuk jeni në hetime

### **MËNYRA E APLIKIMIT:**

Formulari i aplikacionit merret dhe dorëzohet në arkivën e KRM "Pastrimi" SH.A, Rr. "Tahir Zajmi", Nr.5, Prishtinë.

Aplikimi përmes postës: Aplikacioni i kompletuar me dokumente mund të dorëzohet edhe përmes postës në adresën: Rr. "Tahir Zajmi", nr.5, Prishtinë, 10000. Aplikacionet e dërguara me postë duhet të mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 3 tri ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara, nuk do të shqyrtohen fare.

### **KUSHTET E PJESËMARRJES NË KONKURS:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

KRM "Pastrimi" SHA ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

### **VËREJTJE:**

**APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËREKSAVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË KONKURS SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHQYRTOHEN.**

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit.

Për informata më të rëndësishme mund të kontaktoni në nr. tel: +383 (0) 38 603 191



Prema članu 8. Zakona br. 03/L-212 rada, član 4 Upravnog uputstva br.07/2017 o regulisanju postupka konkurencije u javnom sektoru, Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" SH.A u Prištini objavljuje ovo:

## KONKURS

**Naslov pozicije:** Fizički radnik – 5 pozicija

**Institucija:** Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" SH. A – Priština

**Zvanje supervizora:** Izveštaj: Glavni zaposleni

**Radno vreme:** 40 sati nedeljno

**Trajanje zakazane obaveze:** neodređeno vreme

**Dužnosti i odgovornosti :** (kratak opis glavnih zadataka)

- Obavlja sve fizičke zadatke u sakupljanju i utovaru otpada, istovaru kontejnera i čišćenju lokacije oko njih;
- Prema planu rada i redosledu rada, on pravi čišćenje/čišćenje i pranje puteva ili čišćenje puta i pločnika od snega i leda, slanog belog luka;
- Uklanja mrtve pse i mačke i stavlja ih u kontejnere;
- Obavezno je imati korektno ponašanje prema građanima i korisnicima usluga;
- Odgovoran za pažljivo korišćenje kontejnera i alata za rad;
- Druge aktivnosti se obavljaju po komandi vođe.

**Potrebne su veštine :** (potrebne veštine i veštine za ovaj posao)

- Veštine komunikacije i planiranja rada;
- Saradničke, međuljudske veštine i timski rad;

**Kvalifikacije za obrazovno, profesionalno i radno iskustvo:** (kvalifikacije i iskustvo potrebno za ovaj posao)

- Diploma osnovne škole;

**Konkurs je objavljen 24 oktobra 2023 godine, a zatvoren je 07 novembra 2023 godine.**

**Prijava:** Prijava mora da sadrži potrebna dokumenta za konkurs, kao što su:

1. Kopija ID-a;
2. Kopija diplome osnovne škole
3. Izvod iz matične knjige rođenih
4. Dokaz da niste u istrazi

### **REŽIM APLIKACIJE:**

Prijavni formular se uzima i podnosi arhivi KRM "Pastrimi" SH. A, "Tahir Zajmi" St., br.5, Priština.

Prijava poštom: Prijava kompletna sa dokumentima može se podneti i poštom na adresu: "Tahir Zajmi" St., br.5, Priština, 10000. Prijave poslate putem pošte treba da zadrže žig na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu. Prijave poslate putem pošte, koje nose poštansku marku na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu, smatraće se važećim i biće razmotrene ukoliko stignu u roku od 3 tri dana. Prijave koje stignu posle ovog roka i nekomplikovane uopšte neće biti razmatrane.

### **USLOVI UČEŠĆA NA KONKURSU:**

Pravo na primenu imaju svi građani Republike Kosovo starosne dobi većine koji imaju punu sposobnost da deluju, poseduju građanska i politička prava, poseduju neophodnu obrazovnu pripremu i stručnu sposobnost obavljanja zadataka i koji poseduju fizičke veštine potrebne za obavljanje odgovarajućeg položaja.

KRM "Čišćenje" AD nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja prijave svih muških i ženskih osoba iz svih zajednica na Kosovu.

### **UPOZORENJE:**

**PRIJAVE I NEKOMPATIBILNA DOKUMENTACIJA PREMA ZAHTEVIMA NAVEDENIM NA OVOM KONKURSU I ONIMA KOJI STIGNU PO ISTEKU ROKA KONKURSA NEĆE BITI RAZMATRANI.**

Biće kontaktirani samo kandidati koji su ušli u uži izbor.

Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja.

Za više informacija možete nas kontaktirati na br. Tel: +383 (0) 38 603 191





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
Qeveria – Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture*  
*Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure*

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë**  
**për Kushtet Ndërtimore**

**“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Nr. prot: 2316/23 të datës 03.05.2023, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
Ndërtesa e Rilindjes  
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmp-h-rks.gov/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
Telefon: + 381 38 200 32 222

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “NTSH Stina” Sh.p.k, K. Deçanë bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

**DEBAT PUBLIK**

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Kompaninë “NTSH Stina” Sh.p.k, K. Deçan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 02.12.2023 në ora 10:00 në Shkollën fillore “Bajram Curri” Sheshi Haki Ukaj Fshati Strelle i Epërm- Komuna e Deçanit, do të organizohet debat publik nga Kompania “NTSH Stina” Sh.p.k, K. Deçan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për Qendën grumbulluese të automjeteve mbeturinë, mbeturinave metalike dhe mbeturinat nga paisjet elektrike.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Zoom:

Join Zoom Meeting

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmpha1o3bW8vckxadVorQT09>,

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “NTSH Stina” Sh.p.k, K. Deçan, për Qendën grumbulluese të automjeteve mbeturinë, mbeturinave metalike dhe mbeturinat nga paisjet elektrike.

<https://mmp-h-rks.gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [ynm.komente@rks-gov.net](mailto:ynm.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Florid Kurhaski nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m.t. “Nexhmedin Nixha”.

Aksa Advertiment SH.P.K. shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër 811284299.

- Hysen Shehu nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Dy Dëshmorët”.

Besart Sadiku B.I. shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810174673.

- Shkurte Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat nga kl. 1-5 të shkollës fillore “Ukshin Miftari”.

B2 SH.P.K. shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit nr. 810129347.

- Bukurije Memaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Dëshmoret e Kabashit “ Korishe.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Kelvin Jakupi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shme “ Ymer Prizreni “ Prizren.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Liberta Spahija nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat, diplomën dhe certifikatën e maturës të Gjimnazit “Hajdar Dushi”.

- Edmonda Kadriu shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme “Xheladin Deda”.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Urimi Rent a car shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër 811430941.



